RAPORTI I RREGULLT VJETOR
I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE
PËR VITIN 2010

Beograd, 15 mars 2011.

P Ë R M B A J T J A

REALIZIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE LIRISË SË QYTETARËVE NË SERBI – PASQYRË E PËRGJITHSHME 6

TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE 6
Mbrojtja e të drejtës në gjykim të drejtë dhe reforma e gjyqësorit 7
E drejta në privatësi 9
Liria e mendimit dhe e shprehjes 10
E drejta në zgjedhje 11
Liria e medieve, gazetarët 11
Vonimi i restituimit 12

TË DREJTAT SOCIALE DHE EKONOMIKE 13
Shkelja e të drejtave nga marrëdhënia e punës 13
Keqpërdorimi i punës përtej orarit në shëndetësi 15
Refugjatët dhe të zhvendosurit 16

PUNA E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS – QEVERISJA E MIRË DHE E KEQE 17
E drejta në qeverisje të mirë 17
Kodi i qeverisjes së mirë 17
Reforma e administratës shtetërore 17
Legalizimi 18
Rasti i „bebeve të zhdukura“ 18

TË DREJTAT E FËMIJËVE 19
Fëmijët e rrugës 20

DISKRIMINIMI 20

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PJESËTARËVE TË PAKICAVE KOMBËTARE 20
Zgjedhjet për këshillat nacionale të pakicave kombëtare 21
Distanca dhe jotoleranca etnike 21
Punësimi i pjesëtarëve të pakicave kombëtare në shërbimet publike 22
Pozita e Romëve 22
Personat ligjërisht të padukshëm 23
Rreziku nga politizimi 23

TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 23

BARAZIA GJINORE 24
Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave seksuale 25

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE TË PRIVUAR NGA LIRIA 26

POZITA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 27

KOSOVA DHE METOHIA 28
Raporti mbi tregtinë e organeve 28

PAVARËSIA, KUSHTET PËR PUNË 28

EDHE MË AFËR QYTETARËVE 31
Bashkëpunimi me ombudsmanët krahinor dhe lokal 31

I PASQYRA KRYESORE MBI MBROJTËSIN E QYTETARËVE 32

Korniza ligjore për punën e Mbrojtësit të qytetarëve 32

Fushëveprimi i punës së Mbrojtësit të qytetarëve 32

Bashkëpunimi me organet e administratës publike **33**

REKOMANDIMET ME QËLLIM TË PËRMIRËSIMIT TË POZITËS SË QYTETARËVE NË RAPORT ME ORGANET E ADMINISTRATËS **34**

TË DHËNAT STATISTIKORE DHE NUMERIKE MBI AKTIVITETET E MBROJTËSIT TË QYTETARËVE **38**

I KONTAKTI ME QYTETARË **38**

II VEPRIMI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE SIPAS ANKESAVE **42**
Numri dhe klasifikimi i ankesave 42
Rezultati i veprimeve të Mbrojtësit të qytetarëve sipas ankesave 49
Veprimi sipas ankesës në sfera specialistike 55

III INICIATIVAT LIGJORE DHE TË TJERA **67**

IV AKTIVITETE TË TJERA TË MBROJTËSIT TË QYTETARËVE **68**

Në bazë të ligjit 33 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve („Gazeta zyrtare e RS-së“, nr. 79/2005 dhe 54/2007), Mbrojtësi i qytetarëve i parashtron Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë

RAPORTIN E RREGULLT VJETOR
TË MBROJTËSIT TË QYTETARËVE
PËR VITIN 2010

Fjala hyrëse e Mbrojtësit të qytetarëve

Të nderuar,

Para juve është raporti vjetor i Mbrojtësit të qytetarëve për vitin 2010, i katërti që nga zgjedhja e Mbrojtësit të qytetarëve dhe themelimit të këtij organi në Republikën e Serbisë.

Qëllimet e këtij dokumenti janë të shumëfishta:

- që të njoftojë Kuvendin popullor dhe organet, institucionet dhe trupat tjerë, si dhe popullatën e gjerë mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave në Republikën e Serbisë dhe cilësisë së realizimit të të drejtave të qytetarëve para organeve dhe organizatave të cilat ushtrojnë kompetencat dhe zbatojnë dispozitat e Republikës së Serbisë;

- të vë në pah ndryshimet në punën e sektorit publik për të avancuar realizimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe të kontribuojë raportit më cilësor ndërmjet qytetarët dhe organeve të pushtetit;

- që t'i prezantojë Kuvendit popullor dhe opinionit publik aspektet më domethënëse të punës së Mbrojtësit të qytetarëve, në përputhje me parimin e përgjithshëm të përgjegjësisë për kryerjen e punëve publike.

Në vitin paraprak raportues, Mbrojtësit të qytetarëve për herë të parë i ishin krijuar kushtet për punë dhe kishte realizuar kapacitetin e përafërt të institucionit i cili ishte parashikuar në momentin e themelimit të institucionit. Përafërsisht 8.500[1] qytetarët i janë drejtuar Mbrojtësit të qytetarëve në vitin 2010, janë parashtruar mbi 2600 anketa, janë iniciuar 925 procedura të reja të kontrollit të ligjshmërisë dhe rregullsisë në punën e organeve të administratës publike, ka përfunduar puna në më shumë se 1900 procedura, janë lëshuar 90 rekomandime për evitimin e lëshimeve dhe për avancimin e punës, ndërsa në 300 raste, organet e administratës publike, me të pranuar njoftimin e Mbrojtësit të qytetarëve për të filluar kontrollin, vetë kanë korrigjuar lëshimet në punë. Mbrojtësi i qytetarëve, për herë të parë, ka shfrytëzuar të drejtën për të iniciuar procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë te Gjykata kushtetuese, ndërsa Kuvendi popullor ka shqyrtuar amendamentet dhe iniciativat rreth ligjeve në procedurën të cilën kishte iniciuar.

Organet shtetërore dhe organet e organizatat tjera në masë të madhe kanë njohur jo vetëm obligimin, por edhe interesin e vet për të bashkëpunuar me Mbrojtësin e qytetarëve. Kjo ka mundësuar edhe arritjen e rezultateve konkrete dhe eliminimin e pasojave të disa lëshimeve të cilat janë shkaktuar në dëm të të drejtave të garantuara të qytetarëve. Mirëpo, këto rezultate në krahasim me praninë dhe larminë e parregullsive dhe problemeve në punën e administratës publike, nuk janë as për së afërmi arsye për të qenë të kënaqur. Ndryshimet janë të domosdoshme, si në mënyrën se si administrate publike e kupton natyrën dhe mënyrën e punës, ashtu edhe në kapacitetin e institucionit të Mbrojtësit të qytetarëve, nëse dëshirojmë që ai të mos rrënohet nën peshën e detyrave që i janë besuar si dhe pritjeve të forta të qytetarëve.

Mbrojtësi i qytetarëve Saša Janković

[1] Të dhënat precize janë dhënë në pjesën statistikore të Raportit

REALIZIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE LIRISË SË QYTETARËVE NË SERBI – PASQYRË E PËRGJITHSHME

Qytetarët[2] përditë e më shumë bëhen të vetëdijshëm mbi të drejtat e tyre dhe i kërkojnë gjithnjë e më me këmbëngulje dhe vendosmëri, por organet e administratës publike[3] me të njëjtin dinamikë nuk e avancojnë punën dhe efektivitetin e vet në realizimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të cilat iu garantohen me rendin ligjor. Gjithnjë e më e dukshme është pakënaqësia e qytetarëve me punën e organeve të administratës publike dhe me respektimin e të drejtave të tyre pasi që pritjet, një dekadë pas ndryshimeve të realizuara në vitin 2000, me të drejtë janë më të mëdha. Varfëria në rritje tek një numër gjithnjë e më i madh i qytetarëve nuk u mundëson që të shohin përparimet në asnjë sferë të jetës dhe çdo tregim mbi përmirësimet merret gati si fyerje. Mbetet të synohet që, shikuar objektivisht, sferat ku është shënuar përparim në Republikën e Serbisë apo ku konsiderohet se janë krijuar kushtet për të (p.sh. miratimi i një vargu të ligjeve me të cilat ofrohen garanci shtesë për realizimin e të drejtave qytetarët; fillimin e luftimit të dhunës së toleruar për një kohë të gjatë; themelimi i institucioneve të specializuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër korrupsionit, avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në sjelljen para drejtësisë të të dyshuarit për vepra të rënda, shuarja e ndërmarrjeve shoqërore që nuk i janë përshtatur kushteve të tregut) të jenë bazë për avancimin e asaj që është më me rëndësi për numrin më të madh të qytetarëve – mirëqenia ekonomike dhe qasja të drejtës efektive. Në të kundërtën, pakënaqësia gjithnjë në rritje sociale mund të zmbraps për një moment shkallën e arritur të të drejtave qytetarët dhe politikë, pa marrë parasysh se kush është në pushtet në atë moment.

Qytetarët në Serbi ballafaqohen me një mospërputhje midis standardit të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe dokumente të tjera dhe jetës së përditshme. Kjo në veçanti vlen për grupet e cenueshme, siç janë Romët dhe pjesëtarët e pakicave të tjera kombëtare, personat me aftësi të kufizuara, të sëmurët, personat e privuar nga liria, femrat, refugjatët dhe të zhvendosurit, pjesëtarët e pakicave seksuale dhe disa pakicave fetare, fëmijët, rastet sociale, të huajt... Problemet e tyre shpesh nuk nxisin një vëmendje të mjaftueshme publike, deri sa disa prej tyre nuk fitojnë përmasa drastike (p.sh. rasti i vrasjes së shtetasit francez Bris Taton, i cili kontekstualisht nuk mund të ndahet plotësisht nga ndezja e padënuar e ambasadave disa vite më herët). Varfëria në rritje ul shkallën e tolerancës dhe solidaritetit ndërmjet qytetarëve. Fakti që ky proces nuk është karakteristik vetëm për Serbinë, nuk ul dëmin dhe rrezikun e tij.

Derisa numri i parashtresave te Mbrojtësi i qytetarëve rritet nga viti në vit, sistemi i mbrojtjes sociale, penzionale dhe shëndetësore rënkojnë nën peshën e nevojave të qytetarëve. Numri dhe përmbajtja e ankesave për shkak të mungesës së mbrojtjes efektive dhe realizimit të të drejtave sociale, e drejta në gjykim në afat të arsyeshëm, e drejta në posedim të lirshëm të pronës, e drejta në respektimin e dinjitetit nga ana e administratës dhe puna e saj e përgjegjshme, si dhe natyre e lëshimeve në punën e organeve të pushtetit të cilat Mbrojtësi i qytetarëve i konstaton çdo ditë, nuk lënë vend për të qenë të kënaqur.

TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Raporti i Freedom House për vitin 2010 ka ranguar Republikën e Serbisë në pjesën e epërme të shkallëve për nga të drejtat civile dhe politike. Serbia gjithsesi është një shtet ku qytetarët zgjedhin lirshëm përfaqësuesit e tyre politike, me procedurë të përcaktuar në mënyrë demokratike (me disa mangësi për të cilat do të bëhet fjalë më vonë). Kjo, megjithatë nuk mjafton. Kushtetuta, p.sh. garanton shkallë më të lartë të lirisë së medieve, por dispozitat jo cilësore, të pa harmonizuara, dhe

---

[2] Реч „грађани“, баш као и све друге граматички родно опредељене речи, користи се у овом извештају родно неутрално и равноправно означава припаднике, односно припаднице оба пола.

[3] Термин „јавна управа“ користи се у овом извештају да би обухватио како органе државне управе, тако и друге органе и организације, предузећа и установе којима су поверена јавна овлашћења, односно који су прописима овлашћени да одлучују о правима, обавезама и на закону заснованим интересима грађана.

të pazbatuara si duhet në sektorin media kanë mundësuar krijimin e një situate ku besohet gjerësisht se pjesa më e madhe e medieve është e lidhur me partitë e caktuara politike. Kjo, gjithsesi, hedh hije të keqe në lirinë e njëmendtë të medieve, gjegjësisht në të drejtat e qytetarëve në informim objektiv mbi temat politike. Njëkohësisht, inkurajon fakti që në procedurën të cilën e ka iniciuar Mbrojtësi i qytetarëve, Gjykata kushtetuese ka shpallur si jokushtetues dispozita të shumta të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi informimin publik, të cilat paraqitnin një kërcënim juridik shtesë realizimit të plotë të garancisë kushtetuese të lirisë së medieve.

Qytetarët e Serbisë nuk mund të pohojnë se të drejtat politike dhe civile iu mohohen nga regjimi jodemokratik të cilin nuk mund ta ndryshojnë në zgjedhje të lira, ashtu siç ndodh ende në disa rajone të botës. Të gjitha mekanizmat demokratike për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë themeluar formalisht dhe realizojnë funksionet e tyre elementare. Por kjo nuk mjafton në shekullin 21, në shtetin i cili synon të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian.

Përparim domethënës është shënuar me sjelljen e një ligji cilësor mbi shoqatat qytetare, i cili edhe zbatohet mjaft mirë. Por paraqiten problemet të cilat rrjedhin nga zbatimi jo transparent i Ligjit mbi të kishat dhe bashkësitë fetare, për të cilin disa grupe fetare pakicë paraqesin vërejtje në trajtimin e tyre nga ana e organeve shtetërore, ndërsa vija e cila ndan kishën nga shteti mjegullohet përkundër dispozitës Kushtetuese e cila kërkon ndarjen e tyre.

Mbrojtja e të drejtës në gjykim të drejtë dhe reforma e gjyqësorit

Ekzistojnë problemet në realizimin e të drejtës në gjykim të drejtë – para se gjithash për nga gjykimi në afat të duhur kohor, të cilat janë rezultat i jo efikasitetit të gjyqësorit në aspektin afatgjatë.

Qytetarët edhe më tej i ankohen Mbrojtësit të qytetarëve për gjykime të ngadalshme dhe jokorrekte, madje edhe kur dinë se Kushtetuta përjashton kompetencat kontrolluese të ombudsmanit në raport me punën e gjykatave, por dëshirojnë që problemin e tyre t'ia paraqesin institucionit të cilit i besojnë ose konsiderojnë (pa saktë) se parashtrimi paraprak i rastit te Mbrojtësi i qytetarëve është kusht për parashtrimin e lëndës Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg. Qytetarët më së shpeshti ankohen për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, shtyrjes së shpejtë së dëgjimeve, mungesës së gjykatësve gjatë gjykimit, dorëzimi jo i rregullt i ftesave dhe akteve, përpunimi jo azhur i vendimeve dhe i marrjes së vendimeve mbi mjetet juridike. Gjykimet që zgjasin më shumë se tre vjet nuk janë të rralla, dhe drejtësia e cila vjen vonë nuk është drejtësi. Dobësitë në realizimin e kësaj të drejte nuk shpijnë në rrënimin e realizimit të gati të gjitha të drejtat e tjera të qytetarëve, të cilët më nuk mund të mbrohen nga gjykata në mënyrë efikase. Në shumë raste kur qytetarët i drejtohen gjykatës që të vendos mbi mbrojtjen apo realizimin e të drejtës së tij apo saj, në mënyrë paradoksale bëhet shkas, gjegjësisht hyrje në shkeljen e re të të drejtave – madje edhe atëherë kur qytetari ia del mbanë të merr vendim të gjykatës, fillon beteja e re – për realizimin e saj, gjegjësisht realizimin e të drejtës të vërtetuar në gjykatë.

Ndihma juridike nuk është në dispozicion në masë të duhur – shërbimet e avokatit janë të paarritshme për shumë qytetarët për shkak të çmimit, ndërsa në komuna shërbimet e ndihmës juridike pa pagesë kushtëzojnë shërbimet e tyre me kritere shumë të rrepta.

Tek ankesat në punën e gjykatave, Mbrojtësi i qytetarëve i këshillon parashtruesit të ankesave që të ankohen te kryetari i gjykatës kompetente, si dhe Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me dispozitat për rregullimin e punës së gjykatave. Kur është fjala për shkeljen e të drejtës në gjykim në afat të caktuar, qytetarëve u është treguar edhe mundësia për t'iu drejtuar Gjykatës kushtetuese, me parashtrimin e ankesës kushtetuese.

Në opinionin e gjerë kohë pas kohë janë të pranueshme deklaratat e përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv në lidhje me disa veprime të caktuara para organeve gjyqësore të cilat janë në kufi të të lejuarës, apo e kalojnë atë.

Reforma e gjyqësorit

Reforma e gjyqësorit e cila është paramenduar si ilaç, ishte edhe vetë përplot me lëshime të cilat kanë hedhur një hije serioze rregullsisë dhe ligjshmërisë së (ri)emërimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjegjësisht pavarësisë thelbësore të gjyqësorit nga pushteti ekzekutiv.

Kujdestarit për informata me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale ka konstatuar mungesë të transparencës në këtë proces, ndërsa Gjykata kushtetuese ka sjellë një aktgjykim "pilot" në dobi të njërit gjykatës të pa emëruar. Mbrojtësit të qytetarëve i janë drejtuar me ankesës 178 pjesëmarrës në konkurs për (ri)zgjedhjen e gjyqtarëve të cilin e kishte zbatuar Këshilli i lartë i gjyqësorit në vitin 2009. Pas procedurës kontrolluese të zbatuar, Mbrojtësi i qytetarëve kishte konstatuar një varg lëshimesh. Vendimet mbi zgjedhjen, gjegjësisht mos zgjedhjen e gjyqtarëve mandati i të cilit është ndërprerë, e ku ekzistonte supozimi juridik se do zgjidheshin sërish, nuk janë arsyetuar; kandidatëve nuk u janë komunikuar fakte mbi të cilat supozimi i përshtatshmërisë së tyre për funksion ishte hedhur poshtë, dhe as nuk kanë mundur të deklarohen mbi to; kriteret për zgjedhje nuk janë zbatuar në mënyrë transparent; nuk mund të vërtetohej nëse janë ndërmarrë masa për të siguruar përfaqësim të pakicave kombëtare në radhët e gjyqtarëve të zgjedhur. Nuk janë zbatuar si duhet as masat të cilat i kishte urdhëruar Kujdestarit për informata të rëndësisë publike, për të siguruar realizimin e të drejtës së opinionit publik që të njoftohet mbi procedurën e zgjedhjes.

Këshilli i lartë gjyqësor, në përputhje me obligimin ligjor, nuk e ka njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve mbi zbatimin e rekomandimeve. Për këtë, Mbrojtësi i qytetarëve, kishte njoftuar opinionin publik, Kuvendin popullor si dhe Qeverinë e Republikës së Serbisë, por ky njoftimi kishte mbetur pa rezultat e jehonë, përveç te opinion publik.

Mirëpo, vlerësimet e organeve të pavarura kontrolluese, për dallim nga vlerësimet e mëvonshme të institucioneve evropiane, nuk janë pritur mirë nga Këshilli i lartë gjyqësor. Vendimi i Kujdestarit nuk është zbatuar në tërësi, Gjykata Kushtetuese ka pranuar mendime të ndara të Këshillit mbi atë se kishte tejkaluar kompetencat e saj, ndërsa konstatimin e ombudsmanit Këshilli i lartë gjyqësor e kishte hedhur poshtë në mënyrën më të ashpër përmes deklaratës për shtyp si të "vonuar, të tepërt dhe të panevojshëm".

Sugjerimet e akterëve ndërkombëtarë

Mangësitë në sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut të cilat Mbrojtësi i qytetarëve i kishte spikatur në raporte vjetor Kuvendit popullor, siç janë dorëheqjet bllanko, restituimi, kapaciteti i dobët dhe mos koordinimi i administratës, diskriminimi i grupeve të cenueshme, liria e mediave… kanë bërë jehonë shumë më të ulët te institucionet vendore sesa vërejtjet e mëvonshme, pothuajse identike të disa qarqeve ndërkombëtare.

Nuk është e dëmshme që pranohen kritikat dhe sugjerimet miqësore dhe konstruktive nga ana e partnerëve ndërkombëtar. Mirëpo, Mbrojtësi i qytetarëve është i bindur se për realizimin e qëllimi shtetëroro-politik – të anëtarësisë në Bashkimin Evropian, por para se gjithash për realizimin më të shpejtë të të drejtave të qytetarëve, do të ishte shumë më mire nëse partnerët evropian të Serbisë do të mund të thoshin – autoritetet serbe kanë bërë lëshime të caktuara, por institucionet vendore të kontrollit i kanë konstatuar dhe gabimet korrigjohen sipas konstatimeve të tyre, gjë që do të nënkuptonte se sistemi funksionon në mënyrë institucionale. Në vend të kësaj, Komisioni Evropian kishte konstatuar lëshimet, dhe përveç kësaj, kishte dhënë vërejtje se nuk respektohen sa duhet mandati i organeve kontrolluese dhe rregullative të pavarur.

Duhet të vihet në pah edhe tendenca që në nevojat për gëzimin e të drejtave të njeriut të mos reagohet me zbatimin më efektiv të ligjeve ekzistuese, por me hartimin e ligjeve të reja. Mos zbatimi i dispozitave nuk mund gjithnjë të arsyetohet me mos përsosmërinë e tyre.

Tendencat në themelimin e organeve gjithnjë e më të shumta "rregullative të pavarura", kryesisht vetëm në letër, ndonjëherë me metodën e përshkrimit të dobët, zbatimit të "projekteve", madje duke iu referuar në mënyrë të pasaktë shembujve të ngjashëm në shtetet tjera, përputhen me matricën e "brengës" populliste për të drejtat e njeriut, gjegjësisht të largimit të përgjegjësisë të organeve të pushtetit për gjendjen në sferat e tyre tek organet të cilat, për nga natyra e tyre janë mbikëqyrëse, nuk kanë kompetenca ekzekutive, dhe as autorizime ligjore apo kapacitet faktik për të bërë atë, gjë që është puna e atyre të cilët ata i mbikëqyrin, dhe as nuk është ky qëllimi i tyre.

E drejta në privatësi

Brengosin dispozita të caktuara të Ligjit mbi komunikimin elektronik dhe Ligjit mbi shërbimet ushtarake të sigurisë, si dhe mënyra e zbatimit të ligjit mbi shërbimin civil informative të sigurisë. Gjatë procedurës së miratimit të Ligjit mbi Kuvendin popullor, bordi kompetent nuk kishte mbështetur njërin prej dy amendamenteve të Mbrojtësit të qytetarëve gjë që kishte vështirësuar kontrollin e gjyqësorit mbi cenimin e privatësisë në komunikim, të parashikuar me Kushtetutë. Lidhur me argumentet e Mbrojtësit të qytetarëve, në mesin e anëtarëve të bordit mbizotëroi interpretimi të cilin në punën e vet e aplikojnë shërbimet vendore të sigurisë – që në gjykata procedurat e mbikëqyrjes së komunikimeve të qytetarëve mund të dekonspirizoheshin, dhe se të dhënat siç janë lista e numrave të formuar, koha dhe lokacioni i thirrjes, lloji i pajisjes dhe të tjera, nuk janë pjesë e komunikimit, por të dhënat statistikore. Kjo përkundër faktit që gjykata parasheh që Dispozitat mbi të drejtat e njeriut dhe të pakicave të interpretohen në përputhje me praktikat e institucioneve ndërkombëtare të cilat mbikëqyrin zbatimin e tyre[4], ndërsa Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut në disa raste shprehimisht kishte mbetur tek qëndrimi të lista e thirrjeve dhe të dhënat e tjera të cilat operatorët i mbledhin janë të përfshira në nocionin e "fshehtësisë në komunikim". Është pozitive që bordi mbikëqyrës ka pranuar propozimin e amendamentit të dytë i cili i mundëson Kujdestarit për informata me rëndësi publike dhe ruajtje të të dhënave personale të mbikëqyr zbatimin e Ligjit edhe në ato raste kur shërbimet e sigurisë iu ishin qasur të dhënave të ruajtura mbi telekomunikimin e qytetarëve.

Mbrojtësi i qytetarëve ka shprehur keqardhje publike që argumentet dhe qëndrimi unik i organeve të pavarura shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, nuk ishin të mjaftueshëm që Kuvendi popullor të kthejë në përpunim projekt ligjin e qeverisë i cili privatësinë e qytetarëve e bën më të cenueshme sesa që do të duhej të ishte.

---

[4] Kushteta e Republikës së Serbisë, neni 18. par. 3.

Për këtë arsye, Mbrojtësi i qytetarëve dhe Kujdestari për informata me rëndësi publike dhe ruajtjen e të dhënave personale, me iniciativë të një numri të madh të organizatave të shoqërisë civile – shoqatave kombëtare të gazetarëve, gjyqtarëve, avokatëve dhe shoqatave të tjera të internuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kanë iniciuar te Gjykata Kushtetuese vlerësimin e këtyre dispozitave, duke konsiderohet se këto jo vetëm që janë një kërcënim i madh për privatësinë e komunikimit të qytetarëve, por edhe formalisht kundër Kushtetutës.

Vizita preventive kontrolluese agjencionit për siguri dhe informim

Duke u bazuar në obligimin dhe detyrën e Mbrojtësit të qytetarëve (AP) të parashikuar me Kushtetutë dhe me ligj që të kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (dhe të pakicave)[5]; duke pasur parasysh se shërbimet e sigurisë kanë kompetenca dhe mjete që, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin, të zbatojnë procedura speciale të kanë për pasojë devijime nga parimi i jo cenueshmërisë së të drejtave dhe lirive të caktuara të njeriut, Mbrojtësi i qytetarëve në janar/shkurt të vitit 2010, ka kryer vizitën preventive kontrollues agjencionit për siguri dhe informim (ASI).

Qëllimi kryesor i vizitës ishte që të shqyrtohej ligjshmëria dhe rregullsia (përshtatshmëria, proporcionaliteti, etj.) i punës së ASI-it gjatë kryerjes së punëve në kompetencë të Agjencionit përmes të cilave preken të drejtat dhe liritë e garantuara të qytetarëve dhe, sipas nevojës, të jepen rekomandime me qëllim të avancimit të ligjshmërisë dhe rregullsisë së punës së ASI-t si dhe avancimit të respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bazës kushtetuese dhe ligjore, gjithpërfshirjes, dokumentimit, dhe në përgjithësi, rregullsisë së procedurave të cilat ASI i zbaton në punën e vet.

Në bazë të shqyrtimit të Regjistrit qendror evidencues si dhe dokumentacionit të cilin ASI ruan mbi rastet ku kishte zbatuar ndonjë prej metodave, masave apo veprimeve speciale, gjegjësisht mjeteve me të cilat preken disa të drejta të garantuara të njeriut, si dhe në bazë të deklaratave të udhëheqësish dhe një pjese të pjesëtarëve të Agjencionit, Mbrojtësi i qytetarëve ka arritur në përfundim se ASI, kur gjatë punës së vet kufizon liritë dhe të drejtat e caktuara të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Serbisë, iu përmbahet dispozitave të pozitive ligjore. Mënyra se si është organizuar dokumentimi i zbatimit të procedurave dhe masave speciale është i tillë sa që një keqpërdorim eventual mund të regjistrohet, ndërsa autorët e keqpërdorimit mund të identifikohen.

Mirëpo, është konstatuar edhe nevoja dhe mundësia që të avancohet mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të cilat mund të kufizoheshin me punën e Agjencionit, dhe atë në nivelin e:

1. Dispozitave ligjore
2. Akteve nënligjore
3. Procedurave të cilat zbatohen gjatë punës së Agjencionit.

Rrjedha dhe rezultatet janë prezantuar gjerësisht raportin special, i cili i është parashtruar Kuvendit popullor por të cilin ajo nuk e ka shqyrtuar.

Liria e mendimit dhe e shprehjes

Liria e mendimit dhe e shprehjes kryesisht respektohet, edhe pse disa grupe dhe organizata të caktuara formale dhe joformale e kanë keqpërdorur në dëm të të tjerëve dhe moralit të shoqërisë demokratike, gjë që Mbrojtësi i qytetarëve e kishte theksuar publikisht në disa raste.

Është brengosëse që keqpërdorimi i kësaj të drejte gjithnjë e më shumë ndodh në forume dhe bllogje në faqe të internetit, me shprehjen e racizmit, ksenofobisë, nxitjen e urrejtjes dhe jotolerancës nacionale, racore dhe fetare, posaçërisht ndaj pakicave kombëtare (Romët) ndaj të cilat

[5] Ligji mbi Mbrojtësin e qytetarëve („Gazeta Zyrtare e RS-së“ nr.79/2005 dhe 54/2007), neni 1. par. 2.

personat përgjegjës në media dhe organe të pushtetit publik më së shpeshti nuk reagojnë.[6] Kushtetuta dhe ligji ndalojnë dhe sanksionojnë penalisht gjuhën e urrejtjes si dhe çfarëdo formë të diskriminimit, ndërsa Serbia ka ratifikuar edhe Konventën mbi krimin e teknologjisë së lartë, dhe prandaj veprat e natyrës raciste dhe ksenofobiste të kryera përmes sistemeve kompjuterike iu nënshtrohen dënimeve. Mirëpo, përkundër ekzistimit të Shërbimit për luftën kundër krimit të teknologjisë së lartë te Ministria e punëve të brendshme si dhe Departamentit të veçantë për punën kundër krimit të teknologjisë së lart te Prokuroria e lartë në Beograd, aktualisht nuk ka mekanizma efektiv kundër keqpërdorimit të të drejtës në lirinë e mendimit dhe të shprehjes.

E drejta në zgjedhje

Mangësitë e caktuara ekzistojnë edhe në realizimin e të drejtës në votë. E drejta në votë e qytetarëve është ende nën hijen e dorëheqjeve bllanko në kuvend dhe lirisë së partive politike që, në nivelin republikan, pas përfundimit të zgjedhjeve, të përcaktojnë përbërjen përfundimtare të organit më të lartë të pushtetit, me çka krijohen kushte që partitë të marrin rolin e një trupi zgjedhor dhe të modifikojnë vullnetin zgjedhor të qytetarëve sipas dëshirës së vet.

Gjykata kushtetuese e Serbisë, për shkak të arsyeve të njëjta, касирао dispozitat e Ligjit mbi zgjedhjet lokale.

Në raportet e mëhershme, Mbrojtësi i qytetarëve kishte theksuar se "dorëheqjet bllanko" dhe mundësia që partitë të ndajnë mandate jashtë renditjes në listat e votimit paraqesin një pengesë më të madhe realizimit të të drejtave politike, gjegjësisht të drejtës së qytetarëve në votë. Mbesim me shpresë se kjo çështje do të zgjidhet gjatë periudhës së ardhshme të raportimit, në një mënyrë e cila nuk cenon të drejtat e qytetarëve në votë, por edhe mundëson një jetë normale politike dhe parlamentare, për të cilën edhe ekzistojnë zgjidhje në praktika të ngjashme.

Liria e medieve, gazetarët

Liria e medieve është jo vetëm një nga gurthemelet e rendit demokratik, por edhe kusht për realizimin e të drejtës së qytetarëve në informim, i cili është i garantuar me Kushtetutë.

Transparenca e pronësisë së medieve, zgjidhja e vrasjeve të gazetarëve, mbrojtja dhe mbështetja gazetarisë hulumtuese, krijimi i kushteve për konkurrencë fer në tregun lokal, regjional dhe kombëtar të media dhe mbrojtja e të drejtave ekonomike dhe sociale të gazetarëve janë të rëndësisë më të madhe për lirinë e medieve në Republikën e Serbisë.

Gjykata Kushtetuese, në procedurën të cilat sipas detyrës zyrtare e kishte ngritur Mbrojtësi i qytetarëve, ka касирао një varg të dispozitave të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e informimit publik, të cilat paraqisnin kërcënim për lirinë e medieve dhe ishin në kundërshtim me Kushtetutën.

Mbrojtësi i qytetarëve e ka iniciuar procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë me iniciativën e shoqatës së gazetarëve, dhe për këtë paraprakisht kishte siguruar mendimet e ekspertëve eminent vendor për të drejtat e medieve dhe të drejtën kushtetuese.

Është obligimi i shtetit që jo vetëm të mos i cenojë, por edhe t'i krijojë dhe të sigurojë kushtet për zhvillimin e gazetarisë së lirë.

Brengosin rastet e pazgjidhura dhe të reja të dhunës dhe frikësimit ndaj gazetarëve të cilët hulumtojnë dukuritë kriminale siç janë dhuna apo korrupsioni. Gazetarja Brankica Stankoviq me muaj të tërë është nën mbrojtjen e përditshme të policisë për shkak të emisionit „Insider" ku janë prezantuar mënyrat e punës së grupeve të organizuara kriminale. Gazetarët e orientuar kah hulumtimi për një kohë të gjatë kanë marrë përsipër punën e organeve joefikase shtetërore që janë

---

[6] Због тога заслужује да буде поменуто реаговање уредника Јавног сервиса РТС, новинара Зорана Стојковића, који је у ауторском тексту на сајту РТС оштро осудио расистичке нападе и вређања девојчице ромског порекла о чијем је кршењу права Заштитник грађана водио поступак према Министарству просвете, а РТС о њему припремио и емитовао опширан прилог.

aftësuar dhe që kanë për obligim të luftojnë, të zbulojnë dhe të dënojnë format më serioze të krimit, që është një nevojë shumë urgjente e shoqërisë, dhe për shkak të kësaj këta gazetarë bartin pasoja të rënda personale.

Policia ishte joefikase në gjetjen dhe privimin nga liria të individëve të cilët, me paturpësi dhe me brutalitet, kanë sulmuar gazetarin Teofil Panqiqin.

Është mirë që organet e sigurisë shtetërore më nuk janë kërcënim për jetën dhe sigurinë e gazetarëve, ashtu siç ishte rasti në vitet e nëntëdhjeta. Mirëpo, shteti në të cilin ekziston nevoja e madhe që njësitë elite policore të mbrojnë gazetarët, portierin i cili kalon në klubin rival futbollistik, liderët e sektorit joqeveritar, qytetarët, madje edhe politikanët të cilët shprehin qëndrime jo të popullarizuara, dhe i mbrojnë ata nga personat të cilat janë mësuar që veprat e tyre penale të tolerohen, duhet të bëjë shumë më tepër përpjekje për të tejkaluar situata të tilla sesa që do të ishte e nevojshme kjo të bëhet në një shoqëri të vlerave dhe me stabilitet institucional.

Përveç organeve publike, edhe vetë mediat kanë përgjegjësi ndaj lirisë së vet dhe ndaj qytetarëve. Etika gazetareske kërkon që e vërteta apo të drejtat legjitime të atyre për të cilët raportohet, posaçërisht respektimi i supozimit të pafajësisë, të mos sakrifikohet për shkak të tirazhit apo shikueshmërisë.

Përqendrimi i vëmendjes në veshje, ndryshime të pamjes personale dhe "kurioziteteve" nga jeta e personave të cilët janë të lidhur me vepra më brutale kriminale, si të ishte fjala për personat nga estrada, me vetëdije apo pa të rrisin tolerancën individuale dhe shoqërore ndaj krimit dhe kriminelëve. Posaçërisht në shënjestër janë të rinjtë, të cilave me një raportim të tillë, krimi u duket si një model i sjelljes i cili tërheq vëmendjen, dhe jo si një mohim i vlerave universale mbi të cilat janë të bazuara të drejtat e njeriut.

Shoqatat e gazetarëve do t'i kontribuojnë lirisë së medieve nëse bordet e tyre etike fuqizohen si vende ku më së miri dhe më së shpejti bëhet dallim midis lirisë dhe keqpërdorimit jo të rrallë të fuqisë së fjalës publike..

Mbrojtësi i qytetarëve ka përshëndetur aktivizimin e Agjencionit republikan të radiodifuzionit kundër rritjes së përditshme të vullgaritetit, nënshtrimit të epsheve të ulëta dhe komercializimit të paskrupullt në sferën elektronike në Republikën e Serbisë, e cila është një e mirë publike.

Jo gjithçka të cilën njerëzit janë të gatshëm të shikojnë është e lejuar, dhe as nuk duhet që përmes resurseve publike – frekuencave elektronike, të prezantohen bindjet të cilat njerëzit nuk ngurrojnë t'i shprehin apo t'i pranojnë. Shteti është i obliguar që të ruajë dinjitetin minimal të qytetarëve dhe të mos ndërtojë dhe të mbrojë vlera të cekura në Kushtetutë si dhe moralin e shoqërisë demokratike, posaçërisht në kushtet e komercializimit të pamëshirshëm të gati gjithçkaje që na rrethon.

Vonimi i restituimit

Vonesat në miratimin e ligjit mbi kthimin e pronës shkakton paraqitjen e shkeljes së të drejtave pronësore dhe rregullsisë elementare për mijëra qytetarë të Serbisë të cilave restituimi u ishte premtuar edhe para vitit 2000, dhe atë nga forcat politike identiteti i të cilëve trashëgohet në vazhdimësi edhe në ditët e sotshme.

Mbrojtësi i qytetarëve konsiderohet se problemi është i dyfishtë – mungesa e vullnetit politik që të zbatohet restituimi si dhe mos ekzistimi i kapaciteteve administrative që të gjitha veprimet e nevojshme të kryhen në një mënyrë të drejtë dhe efikase. Njëri prej problemeve kyçe është mungesa e evidencave të plota, të sakta dhe azhure mbi pronën në pronësi të shtetit.

Derisa restituimi shtyhet, disa zgjidhje të caktuara ligjore vështirësojnë mundësinë që ish pronarëve t'u kthehet prona në mënyrën më të drejtë – në naturë. Kështu është rasti me dispozitat mbi tokën shoqërore e cila, për përmes procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të cilat e kishin shfrytëzuar, edhe vetë bëhet pronë private.

Organe, qytete dhe komuna të caktuara, kur iu drejtohen shoqatat dhe qytetarët e interesuar, pohojnë se nuk janë të njoftuar mbi konkluzën e Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi paraqitjen e

obligueshme të pronës së tundshme dhe të patundshme shtetërore në Drejtorinë Republikane për pronë, e cila duhet të përpilojë evidencën e pronës së Republikës së Serbisë.

Mbrojtësi i qytetarëve ka ndërmjetësuar ndërmjet organizatave qytetarëve për kthim të pronës dhe Drejtorinë Republikane për pronë. Me rekomandim të Mbrojtësit të qytetarëve, Drejtoria ka ndaluar së refuzuari paraqitjet e qytetarëve të interesuar mbi pronën e cila mund të ishte objekt i restituimit, por ka filluar që të hulumtojë nëse njësitë lokale të vetë-qeverisjes të cilat qytetarët i cekin kanë raportuar në evidencë, dhe nëse jo, nëse janë plotësuar kushtet që kjo të bëhet.

Pas vetëm disa muajve nga fillimi i mënyrës së tillë të punës së Drejtorisë, të kërkuar nga Mbrojtësi i qytetarëve, janë "gjetur" dhe regjistruar si pronë shtetërore:

- 35.288 hektarë të tokës bujqësore,
- 79.273 hektarë të sipërfaqeve pyjore,
- 3.712 hektarë të tokës ndërtimore,
- Mbi 3.000 objekte zyrtare,
- Rreth 24.000 rrugë dhe rrugica,
- Mbi 1.000 objekte banesore,
- 700 garazhe dhe objekte të ngjashme.[7]

Një aspekt i veçantë problemit i shton fakti që, përderisa kthimi i pronës së marrë padrejtësisht nga qytetarët vonohet, Ligji mbi kthimin e pronës kishave dhe bashkësive fetare është në fuqi, gjë që krijon një pabarazi ligjore. Mirëpo, për largimin e kësaj pabarazie po ndiqet një rruge e gabuar: Qeveria ka vendosur që faktikisht të ndalojë me zbatimin e Ligjit për kthimin e pronës kishave dhe bashkësive fetare, derisa Gjykata kushtetuese të mos vendos mbi kushtetutshmërinë e saj, edhe pse me vite mbrapa Ligji ishte zbatuar dhe kishat e caktuara kanë kthyer një pjesë domethënëse të pronës. Në pritje të vendimit të njëjtë, Qeveria ka ndërprerë edhe hartimin e ligjit mbi restitutimin e përgjithshëm. Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se një "ngecje" e tillë është i pabazuar dhe në thelb një procedurë jokorrekte për blerjen e kohës së skaduar para shumë kohësh.

TË DREJTAT SOCIALE DHE EKONOMIKE

Posaçërisht brengosin problemet e mëdha të qytetarëve në realizimin e të drejtave sociale dhe ekonomike, mospërfillja e të cilave mund gjithnjë të vejë në pyetje shkallën e arritur të të drejtave politike dhe qytetare. Është publikuar se çdo të gjashti punëtor në Serbi punëdhënësi nuk ia paguan stazhin obligativ penzional – kjo është investim në një rrënim social! Numri gjithnjë e më i madh i qytetarëve bie nën kufirin e varfërisë. Megjithatë, të hyrat e pakta dhe të parregullta, mungesa e punësimit, mungesa e banimit apo nevojave të tjera elementare materiale për jetesë, nuk janë diçka me të cilin Mbrojtësi i qytetarëve mund t'iu ndihmojë (përveç nëse është pasojë e punës së parregullt dhe të paligjshme të organeve publike), edhe pse individë të caktuar shprehin zhgënjimin e vet në institucionin e Mbrojtësit të qytetarëve, sepse si qytetarë nuk mund t'i ndihmojë. Serbia ka nënshkruar Protokollin opcional të Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Mirëpo, nuk është bërë ratifikimi i këtij nënshkrimi në Kuvendin popullor.

Shkelja e të drejtave nga marrëdhënia e punës

Qytetarët edhe në vitin 2010 i janë ankuar Mbrojtësit të qytetarëve mbi problemet në realizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës. Ata vënë në pah mosrespektimin e disa dispozitave të Ligjit mbi punën nga ana e punëdhënësve, mungesën e mbrojtjes efektive para gjykatave, por janë

[7] Të dhënat të cilat Rrjeti për restituim në Serbi, shoqata e qytetarëve të interesuar i ka ofruar Avokatit të popullit.

të dukshme edhe pasojat dhe mungesa e një dialogu efektiv dhe të qëlluar social ndërmjet shtetit, punëdhënësve dhe përfaqësuesve të punëtorëve (sindikatave).

Punëtorët më së shpeshti i drejtohen Mbrojtësit të qytetarëve pasi që mbeten pa punë, edhe pse në këso situata me punëdhënësit ombudsmani nuk mund t'u ofrojë ndihmë efikase. Ata dëshmojnë se kanë punuar me vite të tëra për një kohë të caktuar (edhe pse ligji në fuqi ndalon formë të tillë të punësimit për një vit) dhe se gjatë marrëdhënies së punës u janë shkelur të drejtat në pushim ditor, javor dhe vjetor, në punë të paguar jashtë orarit dhe të drejtat e tjera, dhe se në rrethinën e tyre punëtorët pranohen me "lidhje", përkatësi partiake apo edhe kundër-shpërblimeve, por që nuk kanë mundur të kërkojnë mbrojtje pasi që marrëdhënia e punës në kohë të caktuar mban punëtorin në një pozitë të pasigurt kundrejt punëdhënësit. Punëtorët e caktuar punojnë me vite të tëra me afat të caktuar. Punëdhënësi iu shmangen dispozitave ligjore mbi kohëzgjatjen maksimale të punës në kohë të caktuar me ndërprerje dhe ndryshime të rrejshme të kontratës së punësimit, ndërsa gjykatat refuzojnë ankesat duke pranuar dokumente fiktive (kontratat për bartjen në vendin tjetër të punës) si të vlefshme. Kuptimi i këtillë i zbatimit të ligjit nga ana e atyre që kanë për detyrë ta mbrojnë nxit shkeljen e të drejtave të punëtorëve.

Numri i madh i qytetarëve në moshë të shtyer janë sjellë deri në maje të ekzistencës pasi që punëdhënësit me vite nuk iu kanë paguar punën dhe as iu kanë paguar stazhin penzional, për çka nuk mund të realizojnë të drejtën e plotë në pension, dhe kështu bëhen të varur nga ndihma sociale e shtetit e cila është e pamjaftueshme për jetë, e për këtë ish punëdhënësit e tyre nuk përgjigjen. Shteti punon në bashkimin e stazhit të punëtorëve nga ndërmarrje të ndara. Mirëpo, nuk është e ditur mbi çfarë kriteresh shteti u ndihmon punëdhënësve të caktuar të lidhin stazhin e punëtorëve të tyre (pasi që obligimi i pagesës së kontributit ishte në anën e punëdhënësit dhe jo punëtorit), ndërsa të tjerëve jo, dhe as mbi çfarë kriteresh disa punëdhënësve u toleron mos pagesën e kontributeve të obligueshme në fondin penzional.

Zgjidhjet aktuale ligjore edhe më tej e hedhin fajin për mos respektim të ligjit nga ana e punëdhënësve në kuptim të pagesës te fondit obligative sociale te punëtorët. Në Republikën e Serbisë ekziston sigurimi i obligueshëm penzional dhe pagesa në fondin penzional është obligim ligjor i punëdhënësit. Fondi i obligueshëm penzional është publik dhe jo privat, që do të thotë se punëdhënësi i bën pagesat komunitetit dhe jo punëtorit. Mirëpo, punëtori bart pasojat nëse punëdhënësi shkel ligjin. Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se çdonjëri duhet ta realizojë të drejtën në pension nga fondi i obligueshëm pa marrë parasysh nëse punëdhënësi i tij ka respektuar ligjin apo jo. Është obligim i organeve shtetërore, dhe jo i qytetarëve, që të sigurojnë respektimin e obligimeve ligjore. Punëdhënësit të cilët nuk paguajnë kontribute për sigurim të obligueshëm penzional dhe shëndetësor e shkelin ligjin dhe është obligimi i organeve shtetërore, dhe jo i punëtorëve, që dukuritë e këtilla t'i zbulojnë dhe t'i sanksionojnë.

Sindikatat i janë ankuar Mbrojtësit të qytetarëve në mungesë të dialogut të obligueshëm social me punëdhënësit dhe me shtetin gjatë marrjes së vendimeve kyçe që prekin punëtorët.

Punëdhënës të caktuar e shfrytëzojnë krizën ekonomike dhe të vlerave, labirintet e procesit të privatizimit dhe mosefikasitetin e mekanizmave të mbrojtjes ligjore për t'u pasuruar në llogari të punës pa pagesë. Por edhe shteti ndonjëherë iu kushtëzon punëtorëve të pjesëmarrje në programet sociale ashtu që atyre u kërkohet të heqin dorë nga kontestet gjyqësore për marrjen e të hyrave të papaguara, duke kërkuar madje edhe që të heqin dorë nga e drejta që u janë konstatuar me vendime të plotfuqishme gjyqësore, edhe pse Kushtetuta i garanton të drejtat e punës dhe thotë se asnjëri nuk mund të heq dorë prej tyre. Në këso rastesh, Mbrojtësi i qytetarëve ka bashkëpunuar ngushtë me Mbrojtësin e qytetarëve në Suboticë.

Mbrojtësi i qytetarëve ka vizituar grevistët të cilët, në një ndërmarrje private (të privatizuar), janë mbyllur në dy hapësira, ndërsa punëdhënësi, duke synuar të ndërpres grevën, me ndihmën e sigurimit ka mbyllur rrethin e fabrikës dhe ka ndaluar sjelljen e ushqimit dhe barnave. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka pranuar apelin e Mbrojtësit të qytetarëve, të përcjellë me një komunikatë se organet shtetërore nuk do të lejojnë sfilitjen e punëtorëve me uri, dhe ky "embargo" i llojit të vet në ushqim dhe barna është ndërprerë por opinioni publik ka mbajtur në mend se shkalla e antagonizmit ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësit mund të ngritet deri në nivelin e të drejtave themelore të njeriut dhe premisave etike.

Në një rast të ngjashëm, Mbrojtësi i qytetarëve në një qytet tjetër ka biseduar me punëtorë të cilat i ishin rrekur vetë lëndimit me qëllim që të dëshmojnë shkallën dramatike të situatës në të cilën gjenden.

Disa zgjidhje ligjore gjithashtu kanë ulur apo kanë vënë në pikëpyetje realizimin e të drejtave individuale të punëtorëve, madje edhe të drejtat themelore nga Ligji i punës.

Mbrojtësi i qytetarëve para Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Ministrisë së kulturës, ka ngritur iniciativën për ndryshimin e nenit 50 të Ligjit mbi kulturën, pasi që puna me kohëzgjatje të caktuar në institucionet kulturore zbatohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi punën, ndërsa punën me orar të caktuar e trajton si përjashtim, në të cilin kanë të drejtë vetëm të punësuar me stazh të punës përtej një numri të caktuar të viteve (20 vjet meshkujt, gjegjësisht 17 vjet femrat). Qëndrimin e Mbrojtësit të qytetarëve mbi rrezikun e nenit 50 për punëtorët në institucionet kulturore e ndajnë edhe përfaqësues të shoqatave të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare të punëtorëve dhe të kulturës. Qeveria nuk ka reaguar në këtë iniciativë. Për shkak të kësaj, Mbrojtësi i qytetarëve është duke përgatitur propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave kontestuese.

Dispozitat e Nenit mbi shërbyesit shtetëror zbatohen për të punësuarit në organe shtetërore, por jo edhe në të gjitha shërbimet publike, dhe vetëm në to nuk ekziston shpallja e obligueshme e konkursit për pranimin e punëtorëve në punë me kohë të pacaktuar. Kështu qytetarët nuk njoftohen për vende të zbrazëta të punës në spitale, agjencione të ndryshme, shërbimet sociale dhe në organet e organizatat e tjera prej të cilave shumë kanë kompetenca publike, gjë që kufizon dukshëm fushëveprimin e dispozitave sipas të cilave të gjithëve, në kushte të barabarta, u janë në dispozicion të gjitha vendet e punës[8]*, e ndikimi i të cilave sipas natyrës së gjërave do të ishte më i madh në sektorin publik.*

Keqpërdorimi i punës përtej orarit në shëndetësi

E drejta në ruajtjen dhe avancimin e shëndetit të qytetarëve, parandalimi, luftimi dhe zbulimi i hershëm i sëmundjeve, lëndimeve dhe çrregullimeve të tjera të shëndetit, mjekimi dhe rehabilitimi me kohë dhe efikas, janë disa prej të drejtave më themelore të qytetarëve të garantuara me rendin ligjor.

Ligji mbi punën, dispozitat e të cilit vlejnë për marrëdhëniet e punës në institucionet shëndetësore, parasheh që i punësuari i cili punon me orar të plotë të punës mund të ligj kontratë mbi punën përtej orarit me ndonjë punëdhënës tjetër, më së shumti deri në një të tretën e orarit të plotë të punës.[9]

Mirëpo, Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore, përmban një përjashtim nga ky rregull dhe të punësuarve në sektorin e shëndetësisë u mundëson që të kryejnë punën përtej orarit, në kushte të caktuara, edhe në institucionin në të cilin janë të punësuar.[10]

Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore lejon që edhe gjatë punës përtej orarit të ofrohen shërbime të cilat mbulohen nga sigurimi i obligueshëm shëndetësor, nëse institucioni shëndetësor „nuk mund të sigurojë ndryshe kuadrin përkatës".[11]

Në procedurën të cilën kishte udhëhequr në bazë të informatave fillestare të cekura në ankesat e dy mjekeve (një ish mjeke), Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se këto dispozitat të Ligjit mbi mbrojtjen shëndetësore mund të keqpërdoren në mënyrën e cila ia hup kuptimin dhe pamundëson realizimin efektiv dhe efikas të të drejtave të pacientit.

Gjatë procedurës së kontrollimit të punës Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se Instituti për onkologji në Kamenicën e Sremit ka organizuar mjekim të të siguruarve shtëpiak përmes punës shtesë në Klinikën radiologjike edhe pse kjo ishte përfshirë në sigurimin e obligueshëm shëndetësor, për atë Instituti ka punëtorë

---

[8] Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 60, par. 3.

[9] Neni 202 i Ligjit mbi punën

[10] Neni 199 i Ligjit mbi mbrojtjen shëndetësore

[11] Neni 200. par. 2. i Ligjit mbi mbrojtjen shëndetësore

adekuat shëndetësor në marrëdhënie të përhershme të punës. Instituti ka filluar të kryejë punët shtesë para se të merrte pëlqimin e nevojshëm të organit përkatës – Ministrisë së drejtësisë, ndërsa me disa nëpunës të caktuar të Klinikës radiologjike ka lidhur edhe kontratë mbi punë përtej orarit përkundër faktit që, për shkak të kushteve të dëmshme të jetesës, u është njohur e drejta në orar të shkurtuar të punës.

Ministria e shëndetësisë e Republikës së Serbisë më vonë kishte dhënë pëlqimin Instituti për onkologji të Vojvodinës për Planin e punës shtesë, edhe pse me atë është parashikuar ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Klinikën radiologjik për të siguruar shtëpiak, ndërsa shërbimet e tilla janë përfshirë edhe me sigurimin shëndetësor dhe për ofrimin e tyre Instituti ka siguruar punëtorët shëndetësor. Është konstatuar se inspektori shëndetësor i Ministrisë së shëndetësisë ka hasur disa parregullsi, por për këto nuk ishte njoftuar themeluesi i Institutit – Krahina autonome e Vojvodinës, dhe as nuk janë ndërmarrë masat efektive për evitimin e tyre. Gjithashtu, Ministria i ka dhënë Institutit pëlqimin për Planin e punës shtesë, por nuk kishte vërtetuar nëse Instituti i plotëson kushtet e parapara.

Pas pranimit të konstatimit të lëshimeve dhe rekomandimeve për evitim të tyre, Instituti ka njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve se në Klinikën radiologjike ka ndërprerë punën shtesë. Sekretariati krahinor për shëndetësi, të cilit Mbrojtësi i qytetarëve i kishte rekomanduar të shqyrtojë peshën e lëshimeve të konstatuara të udhëheqësisë së Institutit dhe të vendos mbi përgjegjësinë eventuale, ka njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve se „pesha e lëshimeve të konstatuara, në këtë moment, nuk është e tillë që të jep shkasë për të ftuar në përgjegjësi udhëheqësin e Institutit, posaçërisht duke marrë parasysh faktin që udhëheqësia ka zbatuar masat e kërkuara për evitim të parregullsive të cilat janë paraqitur gjatë kryerjes së punës shtesë dhe ka bërë gjithçka tjetër për të larguar lëshimet e hasura". Mbrojtësi i qytetarëve ka shprehur pakënaqësi publike për një rezultat të tillë, ndërsa njëra prej mjekeve e cila ka paraqitur problemin pohon se që nga paraqitja e parregullsisë është ballafaquar me persekutim në punë, përkundër shkresës së Mbrojtësit të qytetarëve udhëheqësish së Institutit dhe Ministrisë së shëndetësisë përmes së cilës ka kërkuar mbrojtje për të, sipas ligjit.

Qytetarët ballafaqohen me afate të gjata për fillimin e mjekimit në procedurë "të rregullt", dhe duke ditur se në mjekim koha luan rol të madh, orientohen (nëse kjo është e mundur financiarisht), dhe në thelb pa vullnetin e tyre të lirë, që të paguajnë mjekimin gjatë orarit shtesë të punës pasi që kështu mjekimi fillon shumë më shpejt.

Një procedurë plotësisht tjetër, të filluar për shkak të informatës rreth kamerave në ordinancën gjinekologjike, ka shfaqur një dimension tjetër të problemit.

Gjatë procedurës së kontrollit është konstatuar që kamerat në ordinancë janë vendosur për të ruajtur pajisjet e shtrenjta mjekësore e cila prishej jashtëzakonisht shpesh. Kjo ndodhte, sipas dyshimit të bazuar të drejtorit të institutit, sepse pajisjet funksionale në spitalin shtetëror ulin numrin e pacientëve në ordinanca private, në të cilat punon i njëjti personel mjekësor.

Mbrojtësi i qytetarëve është njoftuar se rastet e keqpërdorimit të orarit shtesë nuk janë të rralla, dhe se në periudhën e ardhshme të raportimit do të merret më intensivisht me këtë çështje dhe të kontrollojë punën e institucioneve shëndetësore.

Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se, pa prejudikuar rezultatin, Kuvendi popullor duhet të rishqyrtojë, përmes dëgjimeve publike apo me ndonjë formë tjetër të përshtatshme, nëse duhet të mbetet edhe më tej mundësia që të punësuarit në organin e administratës publike (organit të pushtetit qendror, krahinor, lokal shërbimit publik, organizatës me kompetenca publike...) pa mekanizma të veçantë të mbrojtjes mund të punojnë punë të llojit të njëjtë gjatë punës shtesë (publike apo private)e që kjo të mes jetë një konflikt interesi i llojit të vet.

Refugjatët dhe të zhvendosurit

Kapitulli i refugjatëve në Serbi ka hyrë në dekadën e dytë, pa ndonjë zgjidhje të qëndrueshme për dhjetëra mijëra njerëz. Në zgjidhjen e nyjeve të shumta dhe problemeve e pyetjeve të shumta të refugjatëve dhe të zhvendosurve janë kyçur organizatat ndërkombëtare, organet tona shtetërore dhe të vendeve fqinje, bashkësia ndërkombëtare dhe evropiane kanë ofruar ndihmë financiare dhe profesionale, ndërsa në aksione të shumta kanë marrë pjesë organizata të shumta joqeveritare dhe humanitare.

Mirëpo, raportet flasin që Serbia edhe më tutje është e para në Evropë, ndërsa 12 apo e 13 në botë për nga numri i refugjatëve dhe personave të zhvendosur.

Refugjatët dhe të zhvendosurit në veçanti janë të goditur rëndë me të gjithë problemet e përgjithshme të cilat i ngarkojnë qytetarët. Bashkëpunimi i Mbrojtësit të qytetarëve me Komisariatin për refugjatë në kuptim të zgjidhjes së ankesave të parashtruara ishte shembullor.

PUNA E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS – QEVERISJA E MIRË DHE E KEQE

E drejta në qeverisje të mirë

Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se organet e administratës shtetërore jo vetëm që duhet të udhëheqin çdo procedurë që ka të bëjë me obligimet, të drejtat dhe interesat e bazuara mbi ligj të qytetarëve në mënyrë të saktë në formë dhe thelb, në mënyrë të qëlluar, objektive, transparente, efikase, profesionale, shpejt dhe me mirësjellje, me respektim të dinjitetit të qytetarëve i cili qëndron para organit të pushtetit, por që qytetarët edhe kanë të drejtë në punën e tillë të administratës publike.

Çdo ankesë tjetër Mbrojtësit të qytetarëve ka të bëjë me heshtjen administrative, ngadalësinë, mosharmonizim të procedurave, zbatimin e gabueshëm të ligjit dhe shkeljet tjera të parimeve të qeverisjes së mirë.

E drejta në qeverisje të mirë është vendosur në sistemin juridik të Bashkimit Evropian si një e drejtë themelore e qytetarëve të saj[12], por edhe në Republikën e Serbisë një e drejtë e tillë ende nuk është pranuar si e tillë. Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se e drejta në qeverisje të mirë edhe te ne duhet të vendoset në të drejta themelore të njeriut, të garantuara me dispozita më të larta juridike vendore.

Kodi i qeverisjes së mirë

Si hapi i parë në këtë drejtim, duke marrë parasysh përvojat e mira të shteteve të tjera të Bashkimit Evropian (BE), Mbrojtësi i qytetarëve ka hartuar një Kod të qeverisjes së mirë dhe në prani të ombudsmanit të BE-së ia ka dorëzuar Kryetares së Kuvendit popullor në qershor të vitit 2010, në mënyrë që parlamenti me autoritetin e vet ta mund ta fuqizojë. Për shembull direkt, Kodi ka marrë Kodin Evropian të sjelljes së mirë administrative (The European Code of Good Administrative Behaviour) i cili, në bazë të raporti special të Ombudsmanit Evropian dhe me iniciativë të tij, është miratuar në Parlamentin Evropian me Rezolutën e 6 shtatorit 2001. Parlamenti Evropian i ka bërë thirrje Ombudsmanit Evropian që të zbatojë Kodin përditë, teksa shqyrton rregullsinë e punës së organeve të Bashkimit, e me qëllim të fuqizimit të të drejtës së qytetarëve në qeverisje të mirë. Kodi do të duhet të shërbejë si udhërrëfyes për sjellje të duhur të organeve të administratës publike si në nivelin republikan, ashtu edhe në atë krahinor dhe lokal. Deri në përmbyllje të kësaj periudhe raportuese, Kuvendi popullor nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet në këtë drejtim.

Reforma e administratës shtetërore

Asnjëri nga qëllimet e përcaktuara të reformës së organeve shtetërore (depolitizomi, racionalizimi, profesionalizimi, modernizimi) nuk janë përmbushur tërësisht, ndërsa realizimi i disa prej tyre as nuk ka filluar denjësisht. Përderisa reformën e administratës shtetërore shumë ekspert e konsiderojnë si problem kyç të tranzicionit, mendimet ekstreme pohojnë se „aparati burokratik i shtrenjtë, i stërmadh, joefikas, joprofesional i korruptuar, me 30 mijë punëtorë të tepërt, është aleat i natyrshëm i pushtetit të paaftë, lakmitar dhe kriminogjen, në luftën që udhëheqin kundër qytetarëve të vet.“[13] Nga njëmijë parashtresa Mbrojtësit të qytetarëve, mund të konkludohet se

[12] Члан 41. Повеље ЕУ о основним правима

[13] Љиљана Татић, есеј „Реформа јавне управе“, фебруар 2010.

qytetarët shpesh e shohin administratën publike si një grup të privilegjuar të përtacëve, "sinekurë" për anëtarët e vlefshëm të partive, kushërinjtë dhe miqtë, një shërbim të korruptuar tej mase, ndërsa nga bisedat me të punësuarit në administratë gjatë procedurës së kontrollit jo rrallë arrijmë në përfundim se ata i konsiderojnë qytetarët lëndë të panumërta, të cilat para tyre paraqesin "ndoshta ligjërisht të arsyeshme, por joreale".

Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se për një reformë thelbësore në sektorin publik çështje kyçe është depolitizimi i administratës dhe ndalimi i praktikës së punësimit në sektorin publik si masë e politikës sociale (synimi që t'i sigurohet punë numrit sa më të madh të qytetarëve, të cilët do të paguhen më pak, ndërsa prej tyre, në kërkim të qetësisë sociale, nuk do të kërkohet cilësi e përgjegjësi). Analiza gjithëpërfshirëse funksionale e sektorit publik është parakusht i racionalizimit të udhëhequr nga nevojat e vërteta, dhe jo nga popullizmi.

Njëkohësisht, inkurajojnë shenjat se shteti fillon të luftojë me më pak kompromis kundër dhunës dhe të tolerojë më pak shkeljen e ligjit, posaçërisht nga ana e zyrtarëve dhe shërbyesve të saj. Rikthehet, edhe pse më ngadalë, kujdesi ndaj arsimit, dhe rritet edhe vetëdija mbi rëndësinë e ambientit të pastër jetësor si dhe të drejtave të tjera, të cilat deri para pak kohe, ishin shpërfillur në tërësi e të cilat janë me rëndësi jetike për cilësinë e jetës sot dhe në të ardhmen.

Ndër shembujt pozitiv është angazhimi i Ministrisë për punë dhe politikë sociale si dhe nënshkrimi më në fund i marrëveshjes bilaterale për mënyrën e realizimit të të drejtave të mbi 15,000 penzionerëve me pensione të përziera serb-boshnjake, me ç'rast janë sjellë në pozitë të barabartë me penzionerët të cilët realizonin pensione në ish republika të tjera jugosllave. Para nënshkrimit të marrëveshjes pranonin pensione më të ulëta, gjë që ishte objekt i ankesës grupore te Mbrojtësi i qytetarëve, por edhe ankesës kushtetuese në Gjykatën kushtetuese.

Nga puna e përgjithshme e Mbrojtësit të qytetarëve në vitin 2010, del se në Republikën e Serbisë ende është shumë e përhapur praktika e shmangies së ligjeve, gjetjes dhe shfrytëzimit të "zbrazëtirave" në to. Kështu mirëmbahet paralelizmi i midis normativës dhe reales, deklaratives dhe praktikes, dhe atë si te ata të cilët zbatojnë ligjet, ashtu edhe te ata tek të cilët zbatohet ligji.

Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se nuk është e mundur të ndryshohet realiteti i rëndë nëse të gjithë kërkojnë respektimin e rregullave dhe ligjeve, por pret që kjo të mos vlejë pikërisht për atë. Ky qëndrim është gjerësisht i pranishëm dhe vërehet si gjatë procedurave të kontrollit të punës së organeve të pushtetit, ashtu edhe gjatë bisedave me qytetarë. Përgjegjësia e të punësuarve në organet e pushtetit është pa diskutim më e madhe – ata puna e të cilave është që të zbatojnë ligjin vetë duhet të shërbejnë si shembull, e kjo shpesh nuk ndodh. Mirëpo, lëshimet në nivelet më të larta të pushtetit, nuk mund të jenë justifikim për mos respektim të ligjit dhe mospërgjegjësi në nivele më të ulëta, por edhe mosrespektim të ligjit nga ana e qytetarëve.

Legalizimi

Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar lëshime masive në zbatimin e procedurave të legalizimit të objekteve, shembjen e objekteve ilegale dhe procedurave të tjera të ndërlidhura me këto çështje. Lëshimet janë pasqyruar në moszbatimin shumëvjeçar të vendimeve të miratuara për shembjen e objekteve ilegale, shembjet selektive, procedurave jotransparente për kërkesat për legalizim, etj.

Të gjitha autoriteteve komunale dhe të qytetarit, si dhe Ministrisë për planifikim hapësinor, u janë drejtuar një varg rekomandimesh për të avancuar ligjshmërinë dhe rregullsinë, por para se gjithash transparencën, objektivitetin dhe efikasitetin e procedurave të legalizimit. Në hartimin e rekomandimeve, Mbrojtësi i qytetarëve ka bashkëpunuar me ministrinë e resorit, si dhe me Konferencën e përhershme të qyteteve dhe komunave. Mirëpo, ligji i ri, ka dhënë disa zgjidhje të reja ligjore, zbatimi i të cilave është duke u përcjellur.

Rasti i „bebeve të zhdukura"

Pas hetimeve disa mujore të cilat kanë përfshirë disa ministri, organe të pushtetit lokal dhe institucione shëndetësore e të tjera, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se nuk është respektuar apo nuk ka ekzistuar një varg procedurash administrative në lidhje me bebet e lindura në dekadat

e kaluara; se disa organe, organizata dhe zyrtarë janë sjellë në mënyrë të papërgjegjshme ndaj dokumentacionit, dhe për këtë arsye ajo sot nuk ekziston apo nuk është e besueshme; se ka ekzistuar një raport johuman, burokratik të disa shërbyesve publik ndaj anëtarëve të familjeve, por për shkak të të gjitha mangësive në dokumentacion dhe kohës së kaluar (në disa raste edhe disa dhjetëra vite), sot me siguri, pa ndonjë procedurë të veçantë hetimore, nuk mund të vlerësohet nëse dikush ka shfrytëzuar pakujdesinë dhe papërgjegjësinë zyrtare dhe në mënyrë të paligjshme, ka ndarë ndonjë bebe nga familja e vet.

Mangësi të caktuara në procedura janë të pranishme edhe sot, prandaj Mbrojtësi i qytetarëve ka dhënë një varg rekomandimesh se si të evitohen ato në afatin sa më të shkurtër, e bashkë me to edhe mundësia që në Republikën e Serbisë të paraqiten raste të reja të „bebeve të zhdukura". Rekomandimet i janë drejtuar Ministrisë së drejtësisë, Ministrisë së punëve të brendshme si dhe Ministrisë për administratën shtetërore dhe pushtetin lokal. Ministritë kanë njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve se kanë vepruar sipas rekomandimeve, prej të cilave pjesa më e madhe është përvetësuar. Mbrojtësi vlerëson që edhe sjellja e një ligjit të veçantë mund t'i kontribuonte zbulimit të së vërtetës për të gjitha këto raste.

Për këtë procedurë, Mbrojtësi i qytetarëve i ka parashtruar Kuvendit popullor një raport të veçantë, i cili nuk është shqyrtuar.

TË DREJTAT E FËMIJËVE

Janë të dukshme përpjekjet e organeve shtetërore të Republikës së Serbisë që të sigurojnë një shkallë sa më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, posaçërisht në planin normativ, por kur normat dhe politikat solide aplikohen në raste konkrete, shihen mangësi të shumta.

Periudhën raportuese e karakterizon vënia në zbatim e parimit të përfshirjes (përfshirjes së fëmijëve me ndonjë formë të pengesës në zhvillim) në procesin arsimor, gjë që është përparimi, por edhe sfida më e madhe. Përkundër rasteve të shumta të zbatimit të suksesshëm të rregullit të ri themelor, janë konstatuar rastet e rezistencës si te punëtorë të caktuar, ashtu edhe te qytetarë të caktuar. Ministria e arsimit shpreh kënaqësi të madhe për faktin se realizimi i parimit të përfshirjes është vërtetuar në shumë shkolla në Serbi, mirëpo rastet problematike nuk marrin vëmendje dhe ndihmë të mjaftueshme institucionale, por rëndësia e tyre zvogëlohet dhe relativizohet. Mirëpo, për fëmijët dhe prindërit të cilët janë gjetur pikërisht në këso rrethanash, përfshirja mbetet një shans i parealizuar për integrimin shoqëror dhe zhvillimin e aftësisë deri në masën më të madhe, gjë që është e drejtë jetike e çdo fëmije.

Kishte raste të dhunës ndaj fëmijëve, madje edhe të formave me ekstreme – vdekjes dhe eksploatimit seksual, madje edhe dhunës nga ana e fëmijëve. Duke konsideruar se dhuna në shkolla nuk mund të luftohet vetëm me sanksione, dhe as të zgjidhen vetëm nga arsimtarët dhe prindërit, Mbrojtësi i qytetarëve u ka bërë thirrje medieve që të raportojnë mbi pasojat të cilat i sjell dhuna, mbi ndikimin e përhershëm që shkakton te viktimat, në vetë-respektin dhe dinjitetin e tyre, por edhe në pasojat fatale për shoqërinë e cila toleron një dhunë të tillë.

Kategoria më e dëmtuar e fëmijëve edhe më tej janë fëmijët me aftësi të kufizuara apo fëmijët me ndonjë pengesë në zhvillim, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët në institucione, fëmijët të nacionalitetit rom dhe fëmijët që jetojnë në familje të varfra.

Duke vepruar në mënyrë preventive, Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi lojërat e fatit për të larguar bastoret larg shkollave. Mbrojtësi i qytetarëve ka përshëndetur në veçanti përpjekjet e kryetarit të Beogradit i cili me angazhimin e shërbimeve të inspekcionit ka konstatuar se 61 bastore dhe klube bixhozi në kryeqytet nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara për distancë nga shkollat fillore dhe të mesme dhe ka ftuar të gjitha qytetet dhe komunat që të zbatojnë masa të ngjashme dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e fëmijëve të shkollave nga organizimi i palejuar dhe i pashembullt i lojërave të fatit.

Fëmijët e rrugës

Vlerësohet se rreth 90 përqind të Romëve të moshës 15 deri 18 vjet nuk shkojnë në shkollë dhe se janë të ekspozuar formave të ndryshme të eksploatimit në punë. Kjo është posaçërisht e dukshme në qytete më të mëdha, ku fëmijët e shumtë romë kërkojnë lëmoshë dhe lajnë dritare të automjeteve në rrugë të frekuentuara dhe të rrezikshme.

Mediat kanë shënuar deklaratën e Mbrojtësit të qytetarëve lidhur me atë çështje se "askush nuk mund të kalojë rrugës në të cilën fëmijët janë të detyruar të kërkojnë lëmoshë apo të shëtisin urëve nën të cilën fle ndonjë fëmi, të mbyll sytë ndaj këtyre dukurive dhe të mbetet me dinjitetin e palënduar".

Organet shtetërore rrallë ndonjëherë ndërmarrin masat gjegjëse dhe "aktivitetet" e tilla arsyetohen me faktin se kjo është mënyra rome e jetesës, gjë që është e pasaktë dhe e papranueshme, nëse për asgjë tjetër atëherë për faktin se në Serbi puna e fëmijëve nën moshën 15 vjet është e ndaluar.

Qeveria e Republikës së Serbisë ka pranuar iniciativën e Mbrojtësit të qytetarëve dhe në javën e fundit të dhjetorit 2009 ka vendosur në qarkullim pullën e veçantë postare të FËMIJËVE TË RRUGËS. Të gjitha pullat janë shitur në kohën rekorde dhe janë realizuar të hyra prej 6.667.680 dinarëve. Me këto të holla është ndihmuar puna e "Strehimores (Svratište)" për fëmijët e rrugëve të Beogradit në vitin 2010, dhe është parashikuar financimin i nismave të ngjashme edhe në Novi Sad dhe Nish. Mbrojtësi i qytetarëve me këtë rast ka bashkëpunuar me sukses me Ministrinë e financave dhe politikave sociale, të cilat, si organe kompetente, kanë kontrolluar shpenzimin e të hollave dhe kanë përcjellur realizimin e programit për fëmijët e rrugëve gjatë vitit 2010.

Megjithatë, ende nuk është gjetur një zgjidhje sistemime dhe e qëndrueshme për fëmijët e braktisur rrugëve në mëshirë të fatit.

DISKRIMINIMI

Në vitin 2010, me procedurat e udhëhequra dhe me hulumtime të tjera, Mbrojtësi i qytetarëve ka regjistruar diskriminime në punën e organeve të administratës publike ndaj personave me aftësi të kufizuara, diskriminimin gjinor, diskriminimin e personave me orientim minoritar seksual, diskriminimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, të moshuarve si dhe grupeve të pakicave.

Zgjedhja e Kujdestarit për mbrojtjen e barazisë paraqet themelimin e një mekanizmi të ri të mbrojtjes ligjore nga diskriminimi, i cili për Mbrojtësin e qytetarëve ka një rëndësi si në thelb ashtu edhe në proces.

Mbrojtësi i qytetarëve, me rregull, nuk inicion më procedura sipas ankesës së qytetarëve për diskriminim nga organet e administratës publike nëse ato paraprakisht, në përputhje me Ligjin, nuk shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse nuk i janë drejtuar Kujdestarit për mbrojtjen e barazisë. Vetëm nëse qytetarët edhe pas procedurës para Kujdestarit pohojnë në mënyrë të argumentuar se të drejtat dhe liritë u janë shkelur me punën e organit të administratës publike, Mbrojtësi i qytetarëve e merr në shqyrtim një ankesë të tillë.

Për shkak të arsyeve të parashikuara me ligj, Mbrojtësi i qytetarëve mund të vendos mbi ankesat për diskriminim në punë nga ana e organeve të administratës publike edhe para se t'i ketë shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion. Për këto raste të jashtëzakonshme Mbrojtësi i qytetarëve, në frymën e parimit të bashkëpunimit të organeve shtetërore, njofton Kujdestarin për mbrojtjen e barazisë.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PJESËTARËVE TË PAKICAVE KOMBËTARE

Zbatimi jo i plotë dhe mosharmonizimi i ligjeve të caktuara me ligjet elementare me të cilat është rregulluar pozita e pakicave kombëtare, janë problemet themelore të realizimit të të drejtave individuale dhe kolektive të pakicave kombëtare, të pranuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Edhe pse thelbi i autonomisë kulturore të pakicave kombëtare është definuar me Kushtetutë dhe me ligje të veçanta – Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe Ligji për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare, organet e administratës publike të cilat duhet të sigurojnë realizimin e këtyre të drejtave nuk kanë themeluar mënyra gjegjëse që kjo edhe të zbatohet në jetën e përditshme, në kushte të ndryshme. Në shumë sfera, realizimin e të drejtave të caktuara të bashkësive kombëtare e vështirëson ose e pamundëson mungesa e akteve nën-ligjore, udhëzimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të cilat duhet t'i miratojnë organet e pushtetit.

Problemet paraqiten edhe në realizimin e të drejtave në përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave në njësitë e vetë-qeverisjes lokale, organet shtetërore, gjykatave, madje edhe të drejtës që në dokumentet publike, emrat dhe mbiemrat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare të shkruhen në gjuhën dhe alfabetin e tyre. Praktika e ndryshme e organeve të vetë-qeverisjes lokale në lidhje me realizimin e të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës dhe alfabetit i sjellin qytetarët në pozitë të pabarabartë përbrenda sistemit të njëjtë juridik.

Mbrojtësi i qytetarëve ka bashkëpunuar posaçërisht frytshëm me anëtarët e Grupit të deputetëve të pakicave në Kuvendin popullor, gjë që e konsideron si jashtëzakonisht të rëndësishme.

Zgjedhjet për këshillat nacionale të pakicave kombëtare

Zgjedhjet dhe konstituimi i këshillave nacionale të pakicave ishin në vitin 2010 përparimi më domethënës institucional në krijimin e kushteve për një përfaqësim më të plotë të pakicave dhe realizimin e të drejtave të tyre kolektive.

Megjithatë, një hije i ka rënë këtij procesi shumë të rëndësishëm për shkak të lëshimeve të cilat kanë sjellë deri te shkelja e të drejtave individuale të qytetarëve (shfrytëzimit të jashtëligjshëm të të dhënave të tyre personale) dhe për shkak të shkeljes së pavarësisë së këshillave nacionale si trupa përfaqësues të pakicave kombëtare, të cilat janë bërë me një rol të pamenduar mirë dhe të ngërthyer në ligje të Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në pjesë të caktuara të procesit.

Mbrojtësi i qytetarëve, pas procedurës së kontrollit dhe konstatimit të lëshimeve, ia ka rekomanduar Ministrisë një sërë masash dhe aktivitetesh, por edhe ndryshimesh normative për të evituar pasojat dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre në të ardhmen. Ai ka iniciuar edhe ndryshimet, gjegjësisht plotësimet në Ligjin mbi pakicat kombëtare për të rritur garancat e legjitimitetit dhe pavarësisë së tyre si trupa përfaqësues, gjegjësisht mbrojtjen nga përzierja e paarsyeshme e shtetit në punën e tyre.

Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, pas një vërejtje publike për mospërmbushjen e obligimit që Mbrojtësin e qytetarëve të njoftojë përbrenda afatit ligjor mbi zbatimin e rekomandimeve, ka informuar Mbrojtësin e qytetarëve mbi masat dhe aktivitetet e ndërmarrura.

Gjatë procedurës është realizuar edhe bashkëpunimi i Mbrojtësit të qytetarëve me Kujdestarin për informata me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe me Kujdestarin për mbrojtjen e barazisë, të cilat i kishin udhëhequr procedurat e mëparshme në kompetencë të tyre dhe kështu ka krijuar një bazë për një qasje gjithëpërfshirëse të Mbrojtësit të qytetarëve ndaj mangësive të identifikuara.

Distanca dhe jotoleranca etnike

Rezultatet e hulumtimit të cilat flasin për rritjen e jotolerancës dhe distancës etnike, si dhe ngjarjet të cilat i mbështesin këto raporte janë në fakt çështje brengosëse.

Fshati i Banatit Jabuka në qershor të vitit 2010 ishte fole e kërcënimeve dhe dhunës kundër Romëve, të cilat ishin nxitur nga një ngjarje tragjike, por shkaku i vërtetë është mospërfillja e jotolerancës etnike ndaj të cilave shteti dhe shoqëria më herët shumë shpesh nuk gjenin përgjigje të duhur. Kështu ka ndodhur që kërkesat legjitime për përgjegjësinë individuale të autorëve të një vepre penale në Jabukë të zëvendësohen me ndjekje në rrugë, dhunë ndaj tërë grupit etnik dhe thirrje për linçimin e të pafajshmëve. Prokuroria në Panqevë ka reaguar me profesionalizëm dhe

vendosmëri. Policia ka vepruar në përputhje me rregullat e profesionit. Udhëheqësit e pushtetit lokal kanë dëshmuar përgjegjësi, ndërsa Kryetari i Republikës dhe Mbrojtësi i qytetarëve kanë vizituar Jabukën në ditën e festimeve të fshatit, në përpjekje që t'i japin fund episodit të jotolerancës ekstreme, gjë që edhe ishte e suksesshme.

Në incidentin e dytë brengosës, policia shpejt ka ndriçuar sulmin në pjesëtarin e pakicës kombëtare gorane në Borçë, në objektin e të cilit është hedhur një bombë e cila ka shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe frikë.

Pas katër rrahjeve në Temerin, iniciuesit dhe viktimat e të cilit ishin pjesëtarë të grupeve të ndryshme etnike, duke pasur parasysh edhe reagimin e organizatave joqeveritare, medieve dhe opinionit publik ndaj këtyre ngjarjeve, Mbrojtësi i qytetarëve ka vizituar vendin, ka mbikëqyrur punën e stacionit lokal policor dhe ka biseduar me përfaqësues të bashkësisë lokale dhe me qytetarë.

Stabilitetit të bashkësisë dhe sigurisë sociale gjithsesi nuk i kanë kontribuar grafitet e urrejtjes të shkruara në gjuhën serbe dhe hungareze, dhe as nuk e kanë bërë këtë raportet e caktuara mediale të cilat bashkësisë së gjerë ia kanë përcjellur porosi të tilla në mënyrë sensacionale dhe jokritike, madje ndonjëherë edhe duke i shkëputur nga konteksti.

Asnjëri nga rastet e përmendura nuk ka qenë (ekskluzivisht) problem lokal. Të rralla janë bashkësitë lokale të cilat mund t'i rezistojnë sfidave të tilla duke u mbështetur vetëm në resurse të veta. Në mënyrë që shoqëria e Serbisë të trashëgojë begatinë e larmisë kulturore, nuk janë të mjaftueshme vetëm garancat Kushtetuese dhe ligjore, por edhe një integrim praktik social i bazuar mbi besim dhe mirëkuptim. Ligjet dhe institucionet duhet të ishin pjesë e një politike përgjegjëse shoqërore e cila në realizimin e integrimit kyç aktivisht edhe shoqërinë civile, kishat dhe bashkësitë fetare, organet vetë-qeverisëse të pakicave e veçanërisht mediat. Zgjidhjet kushtetuese, të bazuara mbi standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të pakicave, duhet të barten në mënyrë më praktike në korniza normative më të ulëta, të zbatohen si duhet, në mënyrë që të luftohet çorientimi i pjesërishëm shoqëror e cila prek njësoj shumicën dhe pakicat.

Punësimi i pjesëtarëve të pakicave kombëtare në shërbimet publike

Në bazë të të dhënave të cilat i ka mbledhur me hulumtime mbi punësimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare si zyrtarë shtetërorë dhe nëpunës në organet shtetërore qeverisëse, në shërbime dhe ndërmarrje publike, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se shumica e organeve të administratës publike dhe shërbimeve publike nuk i zbatojnë dispozitat, nuk planifikojnë masat në lidhje me rritjen e punësimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare dhe nuk mban evidencë mbi strukturën e të punësuarve, ndër të tjera për shkak se për këto veprime nuk janë përcaktuar procedura përkatëse administrative. Përjashtim nga kjo praktikë negative janë organet e KA të Vojvodinës, por edhe Ministria e punëve të jashtme, Ministria e punëve të brendshme, si dhe Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria Tatimore në Ministrinë e Financave, të cilat mbajnë evidencën në fjalë dhe mbi bazë të saj planifikojnë dhe zbatojnë masa të caktuara.

Mbrojtësi i qytetarëve ia ka drejtuar Kryetarit të Qeverisë së RS-së, njëkohësisht edhe Kryesuesit të Këshillit për pakica kombëtare të RS-së, iniciativën për përgatitjen dhe miratimin e bazës ligjore për rregullimin e kësaj lëmie. Deri në periudhën e raportimit nuk është vendosur mbi këtë iniciativë

Gjithashtu, përmes Mendimit të cilin i kishte drejtuar Kuvendit popullor, Mbrojtësi i qytetarëve ka mbështetur amendamentet e Grupit të deputetëve të pakicave kombëtare përmes të cilave gjatë racionalizimit të punës së organeve lokale të vetë-qeverisjes të ushtrohet kujdes që pjesëtarët e pakicave kombëtare të jenë të përfaqësuar si duhet në punën e tyre dhe në shërbime të tjera.

Pozita e Romëve

Mbrojtësi i qytetarëve përcjell posaçërisht realizimin e të drejtave të pakicës kombëtare rome, si bashkësi posaçërisht të cenueshme. Përkundër aktiviteteve të ndërmarrura të organeve shtetërore dhe krahinore si dhe njësive të caktuara të vetë-qeverisjes, pozita e Romëve nuk është avancuar

dukshëm gjatë vitit 2010. Përveç kësaj, mospërfillja shoqërore dhe ambivalenca institucionale për pozitën dhe problemet e Romëve të cilat janë shprehur gjatë zhvendosjes së vendbanimeve ilegale rome në Beograd pa siguruar paraprakisht me kohë banimin e nevojshëm si dhe sulmet raciste të Romëve në fshatin e Banatit të quajtur Jabuka, vë në pah se ekzistojnë problemet komplekse si për nga integrimi i tyre shoqëror, ashtu edhe për nga diskriminimi, luftimin e varfërisë dhe zgjidhjen e problemeve socialo-ekonomike si dhe të drejtave të kulturës. Ombudsmani ka cekur se zgjidhja e problemeve siç janë zhvendosja e Romëve dhe banorëve të tjera nga vendbanimet ilegale johigjienike duhet të realizohet duke respektuar standardet e përgjithshme të përcaktuara, duke siguruar bazën reale për integrimin e mëtejmë socialo-ekonomik, parandalimin e segregacionit hapësinor dhe tensioneve ndër-etnike, sepse në të kundërtën, mund të vjen deri te shpërthimi i jotolerancës sociale dhe etnike. Në rastin e diskriminimit të konstatuar të vajzës rome në sistemin arsimor, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar mungesën e masave efikase dhe efektive të organeve inspektuese, si dhe akteve përkatëse nënligjore mbi kriteret më të qarta për identifikimin e diskriminimit në institucionet arsimore dhe edukative dhe ka propozuar masat për tejkalimin e kësaj situate në praktikë.

Duke konsideruar se problemet me të cilat ballafaqohen Romët në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre janë serioze dhe të shumta, dhe se për shkaqe të ndryshme nuk kanë qasje në institucione, Mbrojtësi i qytetarëve e ka organizuar punën e vet edhe në vendbanimet rome ku pranon ankesat e qytetarëve.

Personat ligjërisht të padukshëm

Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 është marrë me problemin e qytetarëve të ashtuquajtur "ligjërisht të padukshëm", gjegjësisht personave të cilët nuk janë regjistruar në librat amë apo në evidencat tjera (më së shpeshti të zhvendosurit interno nga Kosova dhe Metohia, posaçërisht Romët), dhe prandaj nuk mund të realizojnë të drejtat e tyre qytetare. Mbrojtësi i qytetarëve ka kryer disa procedura të kontrollit të cilat kanë përfunduar me regjistrimin në librat amë dhe lëshimin e dokumenteve për këta persona, ndërsa për zgjidhjen sistemore të këtij problemi, Mbrojtësi i qytetarëve është duke ndërmjetësuar ndërmjet Ministrisë për administratën shtetërore dhe pushtetin lokal, agjencioneve të Kombeve të Bashkuara, Komisionit Evropian dhe organizatave relevante joqeveritare.

Është domethënëse gjykimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në rastin Millanoviq kundër Serbisë ku në dhjetor të vitit 2010 gjykata ka gjetur se Serbia ka shkelur Konventën Evropian mbi të drejtat e njeriut pasi që në periudhën prej dhjetë viteve nuk ka mbrojtur pjesëtarët e organizatës Hari Krishna nga Jagodina nga sulmet e vazhdueshme fizike. Ka munguar edhe zbatimi i obligimit pozitiv të shtetit që të mbrojë pjesëtarët e grupeve të cenueshme të grupeve të pakicave dhe fetare. Për këtë çështje, Ombudsmani ka kryer procedurën para vendimit të Gjykatës Evropiane, por nuk ia ka dalë mbanë që të sigurojë një hetim efektiv policor.

Rreziku nga politizimi

Zgjidhjet e Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare mund të mundësojnë që partitë politike të pakicave kombëtare, e posaçërisht edhe partitë tjera politike, të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e vetë-qeverisjes së pakicave, por që të drejtojnë punën dhe vendim-marrjen e tyre në mënyrë indirekte. Me këtë do të mund të rrënohej në thelb koncepti i të drejtave të pakicave i cili shtrihet në sferën e autonomisë kulturore, dhe në kuadër të kësaj, dhe jashtë proceseve politike, duhet të realizohen të drejtat mbi përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave, mbi arsimin dhe informimin në gjuhën e pakicave, si dhe ruajtjen e identitetit kombëtar.

TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Edhe përkundër Ligjit mbi parandalimin e diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, të cilin Serbia, si vendi i parë në regjion, e ka miratuar qysh në vitin 2006, Strategjisë së miratuar për avancimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara dhe Konventës së nënshkruar të OKB-së

mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, këta qytetarë ballafaqohen me diskriminim dhe margjinalizim për shkak të dispozitave të pazbatuara, por edhe për shkak të lëshimeve në ligjet tjera. Në këtë përfundim shpijnë edhe më shumë se njëqind ankesa të personave me aftësi të kufizuar të cilat Mbrojtësi i qytetarëve i ka pranuar në vitin 2010. Një e katërta e ankesave është vlerësuar si e bazuar, procedurat janë kryer me sukses dhe qytetarët kanë realizuar të drejtat e veta.

Personat me aftësi të kufizuar edhe më tej janë të përjashtuar nga jeta publike, politike dhe kulturore në masë të madhe dhe ballafaqohen me problemet në arsimimi, punësim dhe në realizimin e të drejtave të tjera. Rastet posaçërisht të vështira nga praktika e deritanishme e Mbrojtësit janë problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në përpjekje për të siguruar mjekimin dhe mjetet e nevojshme, si dhe të moshuarit me aftësi të kufizuara, numri i të cilëve në fakt është shumë më i madh sesa që duket, pasi që nuk kanë mundësi që t'iu drejtohen organeve kompetente për realizimin e të drejtave të tyre.

Prioriteti i bashkëpunimit të cilin Mbrojtësi i qytetarëve ka vendosur me Organizatën kombëtare të personave me aftësi të kufizuara (OKPAK) është parandalimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në arsimim, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave të tyre.

Më diskutabil është qëndrimi i personave me aftësi të kufizuara në institucione të tipit të mbyllët, të cilat pamundësojnë integrimin në shoqëri në çfarëdo qoftë mase. Më së shpeshti, kushtet në to janë të rënda dhe u mungon personeli profesional dhe personeli tjetër, gjë që është pasojë e mungesës së mjeteve dhe inercionit të institucionit ndaj një qëndrimi të tillë.

Gjatë vitit 2010 Mbrojtësi i qytetarëve ka kryer 15 vizita kontrolluese në institucione ku janë vendosur personat të cilat varen nga kujdesi dhe ndihma e të tjerëve.

BARAZIA GJINORE

Serbia më në fund i ka pranuar dokumentet sistemore të shumëpritura, me rëndësi për rregullimin institucional të barazisë gjinore, dhe atë Strategjinë kombëtare për përmirësimin e pozitës së femrave dhe avancimin e barazisë gjinore si dhe Ligjin mbi barazinë gjinore. Mbrojtësi i qytetarëve ka përshëndetur sjelljen e Ligjit, para miratimit të të cilit në Kuvendin popullor ka vënë në pah ruajtjen e shprehjes "gjini" dhe domosdoshmërinë e krijimit të një organi të përhershëm punues apo përcaktimit të të punësuarve për barazinë gjinore dhe kryerjen e punëve për realizimin e mundësive të barabarta në organet e njësive të organeve të vetë-qeverisjes. Kuvendi popullor, me rastin e miratimit të Ligjit ka pranuar mendimin e Mbrojtësit të qytetarëve.

Mirëpo, edhe pse janë krijuar kornizat elementare normative, Mbrojtësi i qytetarëve vëren mungesë të kapacitetit për të zbatuar dispozitat ligjore dhe masat praktike të nevojshme. Ulja e nivelit të përgjithshëm të dhunës, madje edhe asaj që ndodh në rrugë, fillon me luftimin e dhunës në familje, viktimat më të shpeshta të të cilave janë femrat. Në rastet e dhunës në familje, të cilat janë pasojë më e dukshme e diskriminimit strukturor, Mbrojtësi i qytetarëve më së shpeshti reagon me iniciativë të vet. Duke hulumtuar këto raste, janë konstatuar dobësi në shkëmbimin e informatave ndërmjet institucioneve, para se gjithash policisë, qendrës për punë sociale dhe shërbimeve shëndetësore. Protokollet mbi bashkëpunimin e këtyre organeve në organet e dhunës në familje në nivelin lokal ose nuk ekzistojnë ose në disa raste zbatohen në mënyrë joefikase. Organet e administratës në strukturat e veta të organizimit dhe në mënyrën e punës zbatojnë stereotipe mbi raportet gjinore dhe dhunën në familje e trajtojnë si një marrëdhënie private ndërmjet meshkujve dhe femrave dhe prindërve e fëmijëve, gjë që sjell deri te zbatimi i vonshëm i kompetencave ligjore. Mungojnë procedurat dhe masat të definuara qartë, «procedurat standarde», por shërbyesit shtetëror kanë të drejtë të gjerë "diskrecionale" për të vendosur se si do të veprojnë në rastin e caktuar. Është e domosdoshme që aktivitetet e organeve kompetente lokale të barten "nga zyra" në terren me qëllim të përcjelljes sa më të mirë dhe reagimit në këto situata.

Në këtë kuptim, është i nevojshëm bashkëpunimi institucional, më i rregulluar i ekipeve profesional si brenda qendrës për punë sociale, drejtorive policore të zonave dhe organeve gjyqësore, por edhe aktorëve të tjerë në nivelin e vetë-qeverisjes lokale, gjë që mund të arrihet me

sjelljen e udhëzimeve më të detajizuara mbi sjelljen e të punësuarve në këto organe në rastet e dhunës në familje, gjë që në disa rrethina veç është arritur.

Në komentuarin e veçantë të Komitetit për të drejtat e njeriut të OKB-së, Mbrojtësi i qytetarëve ka shprehur mospajtimin e vet në lidhje me pikën 47 të raportit shtetëror mbi zbatimin e Paktit mbi të drejtat civile dhe politike. Në raportin shtetëror pohohet se barazia gjinore dhe mbrojtja gjithëpërfshirëse e femrave zbatohet si duhet në praktikë, dhe se dallime të caktuara midis gjinive ekzistojnë për shkak të strukturës psiko-fizike, për shkak të rolit reproduktiv të femrës dhe mbrojtjes së amësisë. Njohuritë e Mbrojtësit të qytetarëve, të bazuara mbi procedurat e kontrollit dhe hulumtimeve, shpijnë në një përfundim tjetër – në Serbi ekziston diskriminimi i femrave, dhe atë në të gjitha nivelet e realizimit të të drejtave dhe lirive të tyre (natyrisht, jo gjithnjë dhe jo gjithmonë). Këtë e ilustron edhe fakti që Kuvendi Parlamentar i Këshillit të Evropës i është kërcënuar me suspendimin e të drejtës në votë delegacionit të Serbisë, pasi që në të nuk ka femra fare.

Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave seksuale

Në vitin 2010, në Beograd për herë të parë është mbajtur manifestimi publik vjetor i pjesëtarëve të orientimit minoritar seksual dhe qytetarëve të tjerë të cilët angazhohen për luftim të diskriminim kundër personave LGTB.

Mbajtja e Paradës së krenarisë në Beograd institucionet evropiane e kanë përshëndetur si përparim në Serbi, por Parada e krenarisë në vitin 2010 mbetet një ngjarje e hidhët.

Forcat shumë të forta policore për kontrollin dhe zmbrapsjen e demonstrimeve kanë ruajtur disa qindra pjesëmarrës të Paradës së krenarisë nga sulmues disa herë më të fortë numerikisht, të cilat sulmet e veta i kanë planifikuar dhe ekzekutuar në mënyrë qartazi të organizuar.

Prania dhe apelet e Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave nuk ishin të mjaftueshme për të larguar përshtypjen se elita politike "kishte kthyer kokën në anën tjetër" dhe i ka lënë policisë në dorë që me shkopinj dhe gaz lotsjellës të luftojë kundër jotolerancës, urrejtjes, frustrimit të grumbulluar, pasojave të rrënimit të sistemit të vlerave, margjinalizimit të kulturës dhe arsimimit... Edhe pse integriteti fizik i pjesëmarrësve ishte ruajtur, porosia e Paradës së krenarisë që ndryshe vetvetiu nuk nënkupton edhe rrezik, dhe se duhet të fshihet, ka mbetur nën hijen e pamjeve të dhunës dhe urrejtjes në rrugët e Beogradit. Deklaratat populliste mbi dëmin për pronën publike dhe private kanë anashkaluar faktin se dëmin nuk e kanë shkaktuar pjesëtarët e Paradës së krenarisë, por ata të cilat kanë dëshirë t'i sulmojnë ata, dhe ishin shumë më të zëshme sesa deklaratat e rralla nga maja mbi domosdoshmërinë që me dhunën të mos bëhet kompromis dhe ajo të mos arsyetohet me asgjë.

Në kohën e mbajtjes së Paradës së krenarisë është sulmuar ndërtesa e Mbrojtësit të qytetarëve dhe në atë janë thyer gati të gjitha dritaret. Përveç policëve të lënduar dhe dëmit material, edhe njëherë është vërtetuar që ballafaqimi i zëshëm me temat "jo të popullarizuara" në Serbi ende ngre një rrezik me vete.

Një prej pasojave të Paradës së krenarisë është edhe numri i madh i të provuarve nga liria në Beograd dhe të ndaluar në burgjet në tërë Serbinë deri në përfundim të procedurës gjyqësore. Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se mbajtja në burg me arsyetimin se me këtë parandalohet kryerja e sërishme e veprës penale në këtë rast vështirë që mund të jetë e arsyetuar – Parada e krenarisë nuk është një manifestim i përditshëm dhe personat LGBT nuk mblidhen përditë në rrugë. Në këtë kuptim, paraburgimi i tillë mund vetvetiu të kuptohej si një sanksion joformal. Mbrojtësi i qytetarëve nuk ka pranuar asnjë ankesë të këtyre personave ku ceket se i ishin nënshtruar keqtrajtimit apo torturës në njësinë e paraburgimit, dhe as nuk ishin në banim më të keq se të tjerët.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE TË PRIVUAR NGA LIRIA

Mbrojtësi i qytetarëve përcjell realizimin e të drejtave të qytetarëve të privuar nga liria të cilët gjenden në paraburgim, në burgje, në ndalesë policore, në ekzekutim të masave të sigurisë, në institute stacionare sociale dhe psikiatrike.

Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka vepruar në rreth 230 raste me iniciativë të vet apo me ankesë të personave të privuar nga liria, ka bërë rreth 50 vizita kontrolluese në stacione policore, burgje dhe institute stacionare sociale dhe psikiatrike (15 vizita stacioneve policore, 20 vizita burgjeve dhe njësive të paraburgimit dhe 15 vizita institucioneve stacionare sociale dhe psikiatrike). Ankesat iu referoheshin më së shpeshti mangësive në kushtet e banimit dhe kushtet e tjera të jetesës të personave të burgosur, por nuk ka pasur ankesa në torturë si një dukuri institucionale, sistemore.

Në bazë të rezultateve të kontrolleve të kryera dhe përcjelljes së vazhdueshme të gjendjes, Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se në Serbi nuk ekziston tortura sistemore.

Megjithatë, kushtet ekzistuese të banimit të personave të privuar nga liria janë të rënda, aq sa në një numër të rasteve mund të karakterizohen si nënçmuese, johumane. Problemet më së shpeshti rrjedhin nga mbipopullimi i burgjeve. Kapaciteti i burgut në Serbi është për gjysmë më i vogël sesa numri i personave të cilët qëndrojnë në të.

Numri i madh i të burgosurve në Serbi nuk kanë shtrat, flenë në dysheme, banojnë në hapësira të lagështa pa ndriçim dhe ajrosje natyrore. Kjo në mënyrë direkte ndikon në realizimin e të drejtave elementare të këtyre qytetarëve, dhe në mënyrë direkte edhe në shoqëri në tërësi – kushtet e dobëta shoqërore, papunësia dhe mungesa e mjekimit adekuat, si dhe mungesa e perspektivës te të dënuarit, nxisin paraqitjen e përsëritjes së krimit.

Është me rëndësi që urgjentisht të ndërtohen kapacitete të reja dhe të zgjerohen ato ekzistuese, dhe të zbatohen masat dhe sanksionet alternative. Konstatimet në Strategjinë e Republikës së Serbisë[14] mbi dobësitë e kapaciteteve të burgjeve tregojnë gatishmërinë e shtetit që të shqyrtojë dhe të paraqes si duhet gjendjen në sistemin e burgjeve. Mirëpo, brengos fakti që mangësitë përsëriten prej vitit në vit. Krahas thirrjeve të vazhdueshme për politikën më të ashpër ndëshkimore, si dhe përfshirjen e një numri të madh të kundërvajtjeve për të cilat është parashikuar dënimi me burg, vëllimi dhe dinamika e masave të parashikuara me Strategji (sanksionet alternative, ndërtimi i burgjeve alternative, lëshimet, amnistia) nuk krijojnë një pritje reale që problemi i mbipopullimit do të zgjidhet së shpejti në mënyrë efikase. Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se ndërtimi i kapaciteteve të reja të burgut, pa vende të mjaftueshme të punës dhe pagave të mjaftueshme që një pjesë e ditës t'i kushtohet fëmijëve, familjes, miqësisë dhe pa planifikim dhe zbatim profesional të risocializimit të personave të privuar nga liria, nuk do të zgjidhet thelbi i problemit. Me rëndësi kyçe afatgjate është edhe preventiva – kthimi i përmbajtjes humaniste në shkolla dhe dhënia e një alternative reale dhe atraktive ndaj sjelljes delikuente (dhe atë jo përmes fushatës mediale, por me krijimin e mundësive konkrete për t'u marrë me kulturë, art...). Vëmendje të veçantë meritojnë personat e vendosur në institucione e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore. Është e nevojshme të krijohen kushtet për kthimin e një numri sa më të madh të qytetarëve me pengesa psikike dhe intelektuale në ambientet natyrore dhe në këtë mënyrë të ulin drastikisht numrin e personave të vendosur në institute të mëdha stacionare. Me rastin e vizitave te institutet sociale dhe shëndetësore të të sëmurëve mental, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se janë tepër të mëdha, të mbipopulluar dhe në rrënim e sipër. Rrethanë vështirësuese është ajo që puna e këtyre instituteve nuk është rregulluar në mënyrë ligjore. Shpesh këto janë azile të cilat përdoruesit, gjegjësisht pacientët e vet i largojnë në mënyrë të pashembullt dhe të përhershme nga bashkësia e njerëzve të lirë. Janë konstatuar rastet kur shërbyesit, gjegjësisht pacientët në to banojnë pa pëlqimin e vet apo pa vendim të gjykatës. Problemi i ngjashëm ekziston edhe te banimi i të moshuarve në institute

[14] Стратегија Владе Србије за смањење преоптерећености смештајних капацитета у заводима за извршење кривичних санкција у Републици Србији у периоду од 2010. до 2015. године

shtetërore dhe private për kujdes – për mbajtjen e tyre në këto institute nuk pa vullnetin e tyre nuk ekziston asnjë bazë ligjore.

Serbia ka ratifikuar OPCAT-in (Optional Protocol to the Convention against Torture – Protokollin Opcional të Konventës kundër Torturës), por që prej disa viteve është vonuar të përcaktojë NPM (National Preventive Mechanism – Mekanizmin Kombëtar Parandalues) në Serbi. Mbrojtësi i qytetarëve, në përputhje me kompetencat dhe obligimet e tij, e me qëllim të realizimit të parandalimit sistemik të torturës, ka formuar Mekanizmin preventiv për monitorimin e instituteve ku janë vendosur personat e privuar nga liria. Mekanizmi preventiv, ekipi shumë-disiplinor në përbërje të juristëve, forenzikëve, psikiatërve dhe psikologëve, është autorizuar që në emër të Mbrojtësit të qytetarëve të vizitojë pa pengesë, pa paralajmërim paraprak, institutet në të cilat janë të vendosur personat e privuar nga liria dhe t'i qaset të gjithë hapësirave në të gjitha institutet, të bëjë kontrolle dhe të sigurojë kopje të dokumentacionit relevant pa marrë parasysh shkallën e fshehtësisë së tyre, si dhe që pa mbikëqyrje dhe në mënyrë të besueshme të bisedojë me personat e privuar nga liria dhe me personelin në institute. Gjatë monitorimit të instituteve, vëmendje të veçantë do t'u kushtojnë fëmijëve, të miturve të rinj, personave me aftësi të kufizuar, personave me nevoja të veçanta, të sëmurëve, personave me orientim LGBT, femrave, pjesëtarëve të pakicave kombëtare, pjesëtarëve të bashkësive fetare dhe të huajve.

Mbrojtësi i qytetarëve është i qëndrimit se zgjidhjes për luftën kundër krimit nuk janë emetimi i incizimeve të arrestimeve të të akuzuarve dhe paraburgimi afatgjatë, por procedurat efikase dhe cilësore gjyqësore si dhe veprimi preventiv praktik.

POZITA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Ligji mbi shoqatat, i miratuar në vitin 2009, është dëshmuar të jetë një kornizë solide normative për regjistrimin dhe punën e organizatave të shoqërisë civile. Në periudhën e ardhshme, rekomandohet përmirësimi i mëtejmë që t'iu mundësohet shoqatave, aktivitetet e të cilëve janë të rëndësisë së përgjithshme, për dallim prej shoqatave aktivitetet e të cilëve janë me rëndësi vetëm për anëtarët e tyre, të kenë mundësinë e lehtësimeve tatimore.

Organizatat e shoqërisë civile të cilat angazhohen për avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut, posaçërisht të drejtave të grupeve të cenueshme, edhe më tutje vihen kohë pas kohe në shënjestër të dhunës. Ekziston edhe një dozë e "armiqësisë" në pjesën e shoqërisë ndaj organizatave joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, liderët e të cilëve shihen si armiq të vlerave tradicionale, ndonjëherë madje edhe si tradhtarë.

Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut ka pranuar një letër kërcënuese për shkak të aktiviteteve të përqendruar në drejtim të gjykimit të krimeve të luftës dhe përkujtimit të viktimave pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre. Në letër u "urdhërohet" anëtarëve që në afat prej një viti të largohen nga Serbia dhe të vendosen në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës, për shkak të mbështetjes së tyre viktimave të luftës në Tuzllë. Në letër thuhet se ata do të jenë nën përcjellje deri në zhvendosjen e tyre dhe nëse nuk zhvendosen do t'iu gjykojë "gjykata me procedurë të shkurtër".

Në prill të vitit 2010, Qeveria ka sjellë rregulloren mbi themelimin e zyrës për bashkëpunimin me shoqërinë civile, detyra themelore e së cilës është të nxit bashkëpunimin e organeve të administratës shtetërore me shoqatat dhe me organizatat tjera të shoqërisë civile. Ministri për administratën shtetërore ka deklaruar pas marrjes së rregullores se themelimi i zyrës do t'i kontribuojë zgjidhjes më efektive të problemeve sociale dhe të tjera, të cilat kërkojnë angazhimin e të gjitha resurseve shoqërore.

Detyra e shtetit me të vërtetë është që të krijojë një ambient të favorshëm për punën e organizatave të sektorit civil, gjë që rrjedh nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të pakicave, si dhe praktikën e institucioneve ndërkombëtare të cilët mbikëqyrin zbatimin e tyre.

Për më tepër, organet shtetërore do të duhet të përmbahen nga çdo akt dhe veprim me të cilin përzihen pa bazë në lirinë e asocijimit. Në tetor të vitit 2010, Mbrojtësi i qytetarëve ka pranuar ankesën e Shoqatës së gjyqtarëve të Serbisë pasi që Këshilli i lartë i gjyqësorit ka kërkuar nga kjo shoqatë një varg të dhënash mbi punën e organeve të tyre, duke iu referuar bazës mos ekzistuese

ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve ka vlerësuar se me sjellje të këtillë të një organi të lartë shtetëror është shkelur e drejta në asocijim, ndërsa deri në ditën e parashtrimit të raportit Këshilli i lartë gjyqësor nuk ka zbatuar rekomandimin e Mbrojtësit të qytetarëve për eliminimin e lëshimit të bërë.

Gjatë vitit 2010, ka vdekur aktivistja e dalluar e shoqërisë civile Biljana Kovaqeviq – Vuqo. Ajo do të mbahet në mend për shkak të çiltërsisë së saj dhe për qëllimet e veta pa kompromis mbi dukuritë dhe rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut. Sektori civil në Serbi ka humbur shumë me vdekjen e saj.

KOSOVA DHE METOHIA

Në një pjesë të Republikës së Serbisë, Krahinës së Kosovës dhe Metohisë (KeM), Mbrojtësi i qytetarëve nuk ka mundësi të realizojë kompetencat e veta në mënyrën e parashikuar me Kushtetutë dhe me ligje. Në përputhje me qëndrimin operativ 11 (j) të Rezolutës 1244(1999) të Këshillit të Sigurimit, UNMIK-u është i obliguar të mbrojë dhe të avancojë të drejtat e njeriut në KeM. Në këtë krahinë funksionon ombudsmani me seli në Prishtinë, me të cilin Mbrojtësi i qytetarëve nuk ka vendosur bashkëpunimin. Në të njëjtën kohë, sipas informatave në dispozicion e në bazë të pohimeve nga ankesat, qytetarët në KeM, posaçërisht ata të nacionalitetit jo-shqiptar të cilët jetojnë në enklava, janë pengje të proceseve aktuale politike dhe ballafaqohen me shkelje të të drejtave të cilat janë të paimagjinueshme në pjesën tjetër të Evropës së sotshme.

Mbrojtësi i qytetarëve, deri në masën e mundur, përpiqet t'iu ndihmojë qytetarëve të të gjitha kombësive në KeM të cilat i drejtohen, duke u nisur nga qëndrimi se, sipas Kushtetutës së Serbisë, kjo është pjesë e vendit tonë, si dhe nga qëndrimi se të drejtat e njeriut dhe ato civile janë të drejtat universale. Pjesa më e madhe e ankesave kanë të bëjnë me mosrealizimin e të drejtave nga sigurimi penzional dhe invalidor, si dhe të drejtës në punë[15]. Mirëpo, Mbrojtësit të qytetarëve nuk i mundësohet që të bëjë kontrollin e punës së organeve të pushtetit në territorin e KeM, madje as atyre të cilët zbatojnë dispozitat republikane. Mbrojtësi i qytetarëve, përmes organeve të EULEX-it, Ministrisë për KeM, është njoftuar që në territorin e Krahinës mund të vjen vetëm nëse administratës i pohon se udhëton për arsye private, gjë që ai nuk kishte pranuar.

Raporti mbi tregtinë e organeve

I brengosur për shkak të raportit mbi shkeljet më të rënda dhe më johumane të të drejtave të njeriut të qytetarëve të Serbisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç janë zhdukjet, vdekja, trajtimi johuman, tregtia me organe njerëzore, Mbrojtësi i qytetarëve i ka propozuar ushtruesit të detyrës së ombudsmanit shqiptar që në opinionin shqiptar dhe në institucione të angazhohet për „hetimin e pavarur dhe të plotë, pa konsiderata dhe konotacione politike", mbi pohimet e parashtruara.

Nga maja e institucionit të ombudsmanit shqiptar Mbrojtësit të qytetarëve i ka ardhur përgjigja ku është shprehur pajtim me qëndrimet e Mbrojtësit të qytetarëve dhe angazhimi për një hetim të pavarur dhe të plotë të të gjithë krimeve të cekura, gjithmonë dhe në çdo vend.

PAVARËSIA, KUSHTET PËR PUNË

Në krahasim me shumicën e shteteve evropiane, Mbrojtësi i qytetarëve si një institucion i ombudsmanit është themeluar relativisht vonë, dy shekuj pas vendeve nordike, gjysmë shekulli më vonë sesa pjesës më të madhe të shteteve të tjera. Koncepti i kontrollit të pavarur të organeve është i ri në Republikën e Serbisë dhe prandaj edhe nuk befason fakti se të gjithë ballafaqohen me sfidat të ndërlidhura me këtë pavarësi dhe me të kuptuarit e pamjaftueshëm të rolit të tyre institucional. Si organ i pavarur shtetëror, për të ruajtur të drejtat e qytetarëve, ka kontrolluar punën e organeve të administratës publike dhe është kujdesur mbi mbrojtjen dhe avancimin e

[15] Paraqitja e hollësishme e punës sipas ankesave për KeM është dhënë në pjesën e veçantë të Raportit.

respektimi të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave[16]. Organet e pavarura kontrolluese të këtij lloji nuk janë organet këshilluese, nuk ekzistojnë që kohë pas kohe të japin këshilla apo komente të cilat organet e pushtetit dhe udhëheqësit e tyre munden, por edhe jo domosdoshmërish, t'i marrin parasysh. Mirëpo, maturimi i kësaj dije, nuk kalon pa format e zakonshme të mohimit të qëllimit të Mbrojtësit të qytetarëve dhe vështirësimit të punës së institucionit të cilat mund të interpretohen edhe si presion ndaj tij.

Për më shumë se tre vjet pas zgjedhjes së mbrojtësit të parë dhe pesë vjet pas miratimit të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve, gjatë vitit 2010, për herë të parë, janë krijuar kushtet hapësinore dhe teknike për punën e këtij organi shtetëror. Mbrojtësi i qytetarëve për herë të parë është vendosur në një hapësirë adekuate (edhe më tutje i përkohshëm, i pesti me radhë) në maj të vitit 2010. Kjo përkundër faktit se Qeveria ka pasur obligimin që me propozim të Mbrojtësit të qytetarëve të sigurojë hapësirat për punën e organeve me të hyrë në fuqi akti për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional, e ky akt ka hyrë në fuqi më 6 nëntor të vitit 2007. Mungesa e hapësirës ka nënkuptuar edhe pamundësinë e punësimit e bashkëpunëtorëve, në periudhën e parë, më kritike të punës së institucionit.

Qeveria e Republikës së Serbisë pa njoftim, pale pëlqimin e Mbrojtësit të qytetarëve gjatë vitit 2010 ka propozuar ribalansin e buxhetit me të cilin Mbrojtësit të qytetarëve i është zvogëluar shuma e mjeteve për pagesën e pagave të të punësuarve. Qeveria në këtë mënyrë me njërën dorë ka dhënë hapësira për shërbimin profesional të Mbrojtësit të qytetarëve, ndërsa me tjetrën ka marrë mjetet për të punësuar ata të cilët duhet të punësojnë në të, edhe pse këto mjete me Ligjin fillestar mbi buxhetin ishin parashikuar. Ligji përndryshe nuk i mundëson Qeverisë që të propozojë buxhetin, dhe as të zvogëlojë buxhetin e Mbrojtësit të qytetarëve pa pëlqimin e tij, por kjo me këtë rast ishte shpërfillur. Ky gabim më vonë është dashur të korrigjohet me ribalansin e ri.

Qeveria gjithashtu ka refuzuar që nga rezervat buxhetore të mundësoj sigurimin e pajisjeve të cilat një hajdut i kishte vjedhur nga hapësirat e përkohshme të Mbrojtësit të qytetarëve në Beogradin e Ri. Paraprakisht, Mbrojtësi i qytetarëve zyrtarisht dhe publikisht ka paralajmëruar se hapësirat ku punon nuk plotëson kushtet elementare për qëndrimin e një organi shtetëror. Ministria e punëve të brendshme ka refuzuar të sigurojë këtë objekt pasi që nuk ishte përfshirë me rregulloren adekuate të Qeverisë, edhe pse mbrojta policore është paraparë me aktin për punën e shërbimit profesional të Mbrojtësit të qytetarëve, për të cilin kishte dhënë pëlqimin edhe Kuvendi popullor. Vetëm pas vizitës së Kryetarit të Republikës Mbrojtësit të qytetarëve në këto hapësira, dhe qëndrimit të tij të shprehur publikisht se Mbrojtësit të qytetarëve dhe organeve të tjera të pavarura duhet t'i sigurohen hapësirat për punë normale, Qeveria ka filluar të zgjidh problemin, të paktën në raport me Mbrojtësin e qytetarëve.

Mbrojtësi i qytetarëve, me vendim të Qeverisë nga viti 2007 është dashur të vendosej në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Serbisë në Rrugën e Resavës menjëherë pas largimit të Gjykatës Supreme të Serbisë, por në këtë objekt, përkundër vendimit të Qeverisë, ishte vendosur Këshilli i lartë gjyqësor. Qeveria më vonë ka sjellë vendimin e ri me të cilin Mbrojtësit të qytetarëve edhe formalisht i ishte marrë hapësira në Rrugën e Resavës (e cila paraprakisht i ishte ndarë në shfrytëzim të përhershëm), dhe i është ndarë në shfrytëzim të përkohshëm hapësira në Rrugën e Deligradit, deri sa të krijohen kushtet për t'u vendosur në Rrugën e Karaxhorxhit nr. 48., që do të duhej të ishte zgjidhje e përhershme. Vlerësohet se për renovimin e këtij objekti nevojiten më shumë se 10 milionë EUR.[17]

Mbrojtësi i qytetarëve është dashur të demantojë edhe deklaratat e ministres për financa që projekt buxheti për vitin 2011 përmban rritjet në shpenzimet publike pasi që në të janë rritur "shumëfish" shpenzimet për punën e organeve të pavarura ku kishte cekur edhe Mbrojtësin e qytetarëve.

---

[16] Neni 138. par. 1. i Kushtetutës së RS-së, neni 1. par. 1 dhe 2. i Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve

[17] Зграда у Карађорђевој 48, изграђена почетком прошлог века, пропадала је у претходном периоду због нерешених имовинских односа и коришћења за потребе снимања филмова, организовања журки и сличне намене супротне њеној сврси и значају.

Rasti i mohimit të qëllimit dhe punës së organeve të pavarur është edhe reagimi i Këshillit të lartë gjyqësor ndaj vendimeve dhe qëndrimeve të këtyre organeve të cilat ata i kanë shprehur gjatë zbatimit të procedurave në kompetencë të tyre gjatë (ri)zgjedhjes së gjykatësve dhe prokurorëve.

Udhëheqësit e organeve të pavarura kontrolluese, posaçërisht Kujdestari për informata me rëndësi publike dhe Mbrojtësi i qytetarëve janë "thirrur" në media të caktuara për shkak të lartësisë së pagës së tyre (Mbrojtësi i qytetarëve me ligj duhet të ketë pagën në lartësinë e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, gjë që nuk ndodhi gjithnjë kështu, ndërsa Kujdestari në lartësi të gjykatësit të Gjykatës Supreme të Serbisë, gjë që gjithashtu nuk është ndodh). Pamundësia për të shpenzuar mjetet e parashikuar me buxhet për shkak të pamundësisë për të punësuar bashkëpunëtorë të nevojshëm ka nxitur edhe një kryetitull në një gazetë ditore "Fryrja e buxhetit".

„Shpenzojnë pa masë!

Është interesat se përveç tepricës së institucioneve shtetërore, ka edhe tepricë të hollave në buxhet! Kujdestari i informatave të rëndësisë publike Rodoljub Shariq, ombudsmani Saša Janković, Agjencioni për luftën kundër korrupsionit, Instituti shtetëror për auditim dhe Trupi koordinues për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë gjithsej kanë pranuar 202.744.341 dinarë më shumë nga buxheti për këtë vit sesa që u duhej realisht. Këto të holla, ashtu siç është parashikuar me ribalansin të cilin Kuvendi duhet të miratojë, ata do ta kthejnë në arkën e shtetit. "Tepricë" më të madhe, pas rekorderit Rodoljub Shariqit (69.499.435) ka edhe auditori kryesor Radosllav Sretenoviqi, dhe atë 61.791.000 dinarë." [18]

Informata e saktë është që përqindja e ekzekutimit të buxhetit të Mbrojtësit të qytetarëve është 92%, me ç'rast në buxhetin republikan ka mbetur një pjesë e mjeteve të pashpenzuara në pozitat: pagat, shtesat, kompensimet dhe kontributet për të punësuarit (shfrytëzuar 91%), ndarjet sociale për të punësuar (shfrytëzuar 54%), shpenzimet e udhëtimit (shfrytëzuar 95%), riparimet dhe mirëmbajtja (shfrytëzuar 66%), tatimet dhe taksat (shfrytëzuar 75%).

Vendimi i Mbrojtësit të qytetarëve që zyrtarisht të merr pjesë në ceremoninë e ndarjes së Çmimit Nobel për paqe, pasi që nga Ministria e punëve të jashtme është komunikuar se këtë nuk do ta bëjë ambasadori i Serbisë në Norvegji, edhe ashtu e vështirë për shkak të kushteve në të cilat është marrë, ka përjetuar një kundërthënie tjetër pasi që mediat kishin transmetuar komunikatën nga Qeveria se Mbrojtësi i qytetarëve udhëton si një i dërguar special i Kryetarit të Qeverisë.

Bashkëpunimi me Qeverinë pati edhe ngritje. Në gusht të vitit 2010, pas takimit me Mbrojtësin e qytetarëve, kryetari i Qeverisë i ka ftuar të gjithë organet e drejtësisë të respektojnë në tërësi obligimin e bashkëpunimit të Mbrojtësit të qytetarëve gjatë procedurave të kontrolleve dhe zbatimit të rekomandimeve të këtij organi. Kryetari i Qeverisë dhe Mbrojtësi i qytetarëve paraprakisht kishin vlerësuar bashkërisht se mungesa e përgjegjësisë për lëshimet e vetëdijshme, ndonjëherë të qëllimshme dhe shkelja e të drejtave rrënon besimin në institucione dhe demotivon zyrtarë të përgjegjshëm shtetërorë. Janë pajtuar edhe për nevojën që me një urgjencë dhe vëmendje të veçantë të udhëhiqen të gjitha punët e administratës ndaj personave juridik kundër të cilëve janë iniciuar procedurat për shkak të dyshimit se me veprimet e tyre të paligjshme apo jokorrekte kanë dëmtuar qytetarët.

Kryetari i Qeverisë dhe Mbrojtësi i qytetarëve janë pajtuar mbi nevojën e kujdesit më të madh të organeve të shtetit për kryerjen e obligimit ligjor të punëdhënësve që punëtorëve t'u paguajnë obligimet në fondet penzionale dhe ato të tjera publike. Mbrojtësi i qytetarëve ka insistuar që organet e shtetit dhe institucionet publike nuk duhet të bëjnë afarizëm me punëdhënës të cilat i kryejnë obligimet ndaj punëtorëve të vet në mënyrë jo të rregullt.

Kryetari i Qeverisë në takimin me Mbrojtësin e qytetarëve në gusht të vitit 2010 ka paralajmëruar që Qeveria, në përputhje me obligimin ligjor, të vendos mbi iniciativat të cilat i ka parashtruar Mbrojtësi i qytetarëve, posaçërisht për iniciativën që të ndryshohet neni 50 i Ligjit mbi kulturën për shkak të shkeljes së të drejtave të të punësuarve në institutet kulturore, dhe iniciativës që të konkretizohet mënyra e realizimit të obligimit kushtetues mbi përfaqësimin e pjesëtarëve të

[18] Gazeta ditore Kurir e 23. 11. 2010.v., faqe 2.

pakicave kombëtare në organet e administratave publike. Mirëpo, deri në përfundim të periudhës së raportimit, kjo ende nuk ka ndodhur.

Kuvendi popullor, në vitin 2010 ka miratuar ndryshimet e Rregullores së punës me të cilat është krijuar mundësia e kontrollit politik ndaj organeve të pavarura përmes mekanizmit të miratimit / mosmiratimit të raportit dhe inicimit të procedurës së përgjegjësisë në rast të mosmiratimit të raportit. Më herët, i njëjti rregull ishte parashikuar me propozimin e Ligjit mbi Kuvendin popullor, dhe nga ai me kërkesë të propozuesve ishte tërhequr, pasi që Mbrojtësi i qytetarëve kishte propozuar amandmane. Mbrojtësi i qytetarëve dhe organet e tjera të pavarura kanë vënë në pah mangësinë e një procedure të tillë, mirëpo vetëm pas kritikave nga bashkësia ndërkombëtare, para se gjithash nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian, Rregullorja e Punës është ndryshuar sërish dhe me rregulla të reja është krijuar baza për të arritur një baraspeshë ndërmjet parimeve të pavarësisë të organeve kontrolluese, të parashikuar me Kushtetutë në njërën anë, dhe mbikëqyrjes së punës së tyre nga kuvendi si një pasqyrim i parimit të llogaridhënies në çdo funksion publik në anën tjetër. Mirëpo, me Rregulloren e punës, edhe më tej nuk është përcaktuar mënyra e realizimit të dispozitave të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve mbi bashkëpunimin e Kuvendit popullor me Mbrojtësin e qytetarëve, edhe pse me Ligjin për Mbrojtësin e qytetarëve, të miratuar në vitin 2005 ishte parashikuar një afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi që Kuvendi popullor të harmonizojë dispozitat e Rregullores së Punës me atë. Mbrojtësi i qytetarëve që në vitin 2008 i ka dërguar Kuvendit popullor një varg amendamentesh për Rregulloren e Punës të cilat nuk janë shqyrtuar asnjëherë.

EDHE MË AFËR QYTETARËVE

Gjatë vitit 2010, përveç vizitave të rregullta dhe kontrolluese mbi punën e organeve qeverisëse, Mbrojtësi i qytetarëve në disa raste (pesë herë) ka vizituar edhe në mënyrë preventive komunat e Bujanocit, Medvegjës dhe Preshevës, e më tej edhe Somborin, Zrenjaninin, Negotinin, Uzhicën, Dimitrovgradin dhe Kraljevën. Gjatë vizitave janë mbajtur takime të punës me përfaqësues të vetë-qeverisjes lokale, janë organizuar tribuna dhe tryeza të rrumbullakëta, dhe janë pranuar edhe ankesat e qytetarëve.

Bashkëpunimi me ombudsmanët krahinor dhe lokal

Bashkëpunimi i Mbrojtësit të qytetarëve me Ombudsmanin e Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe ombudsmanët e pushteteve lokale është rregulluar me Ligj, ndërsa zhvillohet përmes cedimit zyrtar të ankesave dhe bashkëpunimit të shtjellimit të tyre, shkëmbimin e praktikave të mira, dhe trajnime të kohëpaskohshme të përbashkëta për të punësuarit në shërbimet profesionale. Deri në fund të vitit 2010, më pak se 10% të organeve lokale të vetë-qeverisjes kanë zgjedhur ombudsmanin lokal dhe shumë prej tyre ballafaqohen me probleme serioze në realizimin e pavarësisë së tyre apo sigurimit të kushteve themelore për punë. Ombudsmani dhe Ombudsmani Krahinor posaçërisht bashkëpunojnë ngushtë për çështje të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare, dhe kanë dhënë një numër të vogël të rekomandimeve të përbashkëta, si dhe në sferën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Në praktikë, gjithnjë e më shpesh paraqitet problemi i konfliktit të kompetencave të ombudsmanit lokal, krahinor dhe kombëtar, të cilat rrjedhin nga mosharmonizimi i Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve dhe dispozitave lokale dhe krahinore mbi punën e ombudsmanëve. Dispozitat krahinore dhe një numër i dispozitave lokale ombudsmanëve të "vet" i caktojnë fushëveprim të punës i cili ndeshet me fushëveprimin e Ombudsmanit republikan të parashikuar me ligj, madje shtrihen edhe përtej kësaj. Problemet paraqiten edhe për shkak të hutimit të identitetit i cili paraqitet për shkak të faktit se Ligji mbi vetë-qeverisjen lokale për ombudsmanët lokal ka paraparë të njëjtin emërtim të cilin Kushtetuta dhe Ligji për Mbrojtësin e qytetarëve e kanë paraparë për ombudsmanin republikan.

Mbrojtësi i qytetarëve në vitin 2010 ka pranuar 314 ankesa të cilat iu referohen punës së organeve lokale të vetë-qeverisjes. Përmes ombudsmanëve lokal ka pranuar 82 ankesa, ndërsa 9 sosh i ka kthyer në kompetencë të tyre.

I PASQYRA KRYESORE MBI MBROJTËSIN E QYTETARËVE

Korniza ligjore për punën e Mbrojtësit të qytetarëve

Mbrojtësi i qytetarëve i Republikës së Serbisë është një organ i pavarur dhe autonom shtetëror, i vendosur në rendin ligjor të Republikës së Serbisë në vitin 2005 me Ligjin për Mbrojtësin e qytetarëve[19] (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe, më pas, i përcaktuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Serbisë[20].

Pavarësia e Mbrojtësit të qytetarëve është një nga parimet themelore të institucionit, i cili është marrë nga dokumentet ndërkombëtare për Ombudsmanin dhe i cili nënkupton se Mbrojtësi i qytetarëve është i ndarë në mënyrë organizative dhe funksionale nga organet qeverisëse[21] punën e të cilëve e kontrollon. Nga parimi i pavarësisë rrjedh parimi i pavarësisë së Mbrojtësit të qytetarëve, i cili nënkupton se i kryen detyrat në mënyrë të pavarur brenda juridiksionit të tij, përkatësisht ua ndalon të tjerëve që të ndërhyjnë në punën dhe veprimet e tij.

Me përkufizim të tillë kushtetues dhe ligjor, Republika e Serbisë e ka krijuar konceptin e Ombudsmanit Parlamentar të tipit të përgjithshëm. Mbrojtësi i qytetarëve është një organ shtetëror përgjegjës për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave të qytetarëve. Mbrojtësin e qytetarëve e zgjedh Kuvendi Popullor, për dallim nga një numër i vogël vendesh ku Ombudsmanët e përgjithshëm ose të specializuar emërohen nga ekzekutivi.

Mbrojtësi i qytetarëve vepron në përputhje me Kushtetutën, ligjet, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, si dhe traktateve ndërkombëtare të ratifikuara dhe rregullave të gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare. Kushtetuta dhe ligji gjithashtu parashohin që Mbrojtësi i qytetarëve t'i raportojë Kuvendit Popullor mbi punën e vet.

Fushëveprimi i punës së Mbrojtësit të qytetarëve

Në një proces relativisht të shpejtë të liruar nga formalitetet e tepërta, Mbrojtësi i qytetarëve mbikëqyr respektimin e të drejtave të qytetarëve, përcakton shkeljet bëra me akte, veprime apo mosveprime të organeve të administratës, nëse është fjala për shkelje të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme republikane. Mbrojtësi i qytetarëve shqyrton (Kushtetuta dhe ligji thotë - kontrollon) nëse organi i administratës publike ka vepruar në mënyrë të ligjshme dhe të duhur në çështjet që lidhen me të drejtat, liritë ose interesat e qytetarëve të bazuara mbi ligj. Nëse kjo nuk ka ndodh, Mbrojtësi i qytetarëve konstaton lëshimin dhe rekomandon se si të evitohet në atë dhe raste të tjera. Shumë më tepër sesa respektimin formal të ligjit, Mbrojtësi i qytetarëve shqyrton etikën, ndërgjegjen, paanshmërinë, profesionalizmin, dobishmërinë, efikasitetin, respektimin e dinjitetit të palëve dhe virtytet të tjera të cilat duhet të karakterizojnë administratën publike të cilën qytetarët me të drejtë presin nga ata të cilët i paguajnë si taksapagues.

Mbrojtësi i qytetarëve kontrollon punën e organit të administratës shtetërore, organin kompetent për mbrojtjen ligjore të të drejtave dhe interesave pronësore të Republikës së Serbisë, si dhe organeve dhe organizatave të tjera, ndërmarrjeve dhe institucioneve të cilëve iu janë besuar kompetenca publike. Mbrojtësi i qytetarëve nuk është i autorizuar të kontrollojë punën e Kuvendit Popullor, Kryetarit të Republikës, Qeverisë, Gjykatës Kushtetuese, gjykatave dhe prokurorëve publikë.

---

[19] Ligji për Mbrojtësin e qytetarëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", Nr 79/05 dhe 54/07).

[20] Vendimi për shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Serbisë botuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", Nr 83/06 dhe 98/06 (Pjesa e pestë - Sistemi i Qeverisjes, seksioni 5, "Avokati i Popullit", neni 138).

[21] Ligji për Mbrojtësin e qytetarëve (neni 1) i futur akronimi me të cilën autoritetet shtetërore, autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të të drejtave pronësore dhe interesat e Republikës së Serbisë, si dhe agjencitë e tjera dhe organizatat, kompanitë dhe institucionet te ngarkuara me kompetenca publike, të shënuar në tekstin e Ligjit si "organet e qeverisjes". Për të shmangur komplikimin e panevojshëm të tekstit të Raportit, shkurtesa e cekur është përdorur edhe në këtë raport.

Krahas të drejtës për të iniciuar dhe për të zhvilluar procedura të kontrollimit të punës së organit të administratës publike, Mbrojtësi i qytetarëve, me anë të shërbimeve të mira, ndërmjetësimit në mes të qytetarëve dhe organeve administrative dhe dhënies se këshillave dhe mendimeve për çështjet brenda kompetencave të tij, të veprojë në mënyrë parandaluese, me qëllim të përmirësimit të punës së organeve të administratës publike dhe avancimin e mbrojtjes se të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mbrojtësi i qytetarëve e ka edhe të drejtën e iniciativës legjislative. Kështu, mund të propozojë ligje brenda juridiksionit të tij, të paraqesë nisma për të ndryshuar apo për të miratuar dispozita të reja nëse konsideron se për shkak të mungesës së tyre vjen deri te shkelja e të drejtave të qytetarëve, ose ku është me rëndësi për realizimin dhe përmirësimin e të drejtave të qytetarëve. Mbrojtësi i qytetarëve është gjithashtu i autorizuar që Qeverisë dhe Parlamentit t'i jep mendime për dispozitat aktualisht në përgatitje e sipër. Gjithashtu, Mbrojtësi i qytetarëve është i autorizuar të iniciojë procedurën para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme.

Rekomandimet, pikëpamjet dhe opinionet e Mbrojtësit të qytetarëve nuk janë ligjërisht të obligueshme. Puna e Mbrojtësit të qytetarëve nuk është që të detyrojë, por që me forcën e argumenteve, si dhe me autoritetin institucional dhe personal, të bind për domosdoshmërinë e eliminimit të mangësive dhe avancimit të mënyrës së punës.

Organet administrative, megjithatë, kanë obligim ligjor që të bashkëpunojnë me Mbrojtësin e qytetarëve, t'i lejojnë qasje në hapësirat e tyre dhe t'i vënë në dispozicion të gjitha informatat që disponojnë, pavarësisht nga shkalla e sekretit (kur është në interes të procedurave në zhvillim e sipër). Mospërmbushja e këtyre obligimeve ligjore është bazë për fillimin e procedurave përkatëse disiplinore dhe të tjera.

Mbrojtësi i qytetarëve mund të rekomandojë shkarkimin e një zyrtari i cili është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të qytetarëve, të iniciojë veprime disiplinore ndaj punonjësve në organin administrativ, të paraqesë kërkesë, gjegjësisht propozim për inicim të procedurës penale, të kundërvajtjes apo procedurës tjetër përkatëse.

Bashkëpunimi me organet e administratës publike

Edhe pse respektimi i të drejtave të qytetarëve nga ana e autoriteteve publike dhe qëndrimi i tyre ndaj qytetarëve dhe të drejtave të tyre në përgjithësi nuk mund të vlerësohet si e kënaqshme, mund të thuhet se shteti dhe organet tjera dhe organizatat gjatë punës dhe ekzistencës katër vjeçare të Mbrojtësit të qytetarëve, e kanë njohur në masë të madhe, jo vetëm obligimin, por edhe interesin vetanak për të bashkëpunuar me të. Këtë, në vitin 2010, e ka mundësuar rritjen e nivelit të bashkëpunimit në një nivel më të lartë dhe zbatimin e plotë të qëllimit të institucionit të ombudsmanit.

Si një shembull i bashkëpunimit të mirë mund të merren marrëdhëniet me Ministrinë e Punës dhe mirëqenies sociale në zbatimin e rekomandimeve në fushën e të drejtave të fëmijëve. Pas keqkuptimeve fillestare rreth kuptimit dhe rëndësisë së rekomandimeve të Mbrojtësit të qytetarëve, një praktikë e ngjashme është duke u vendosur edhe me Ministrinë e arsimit, gjë që ishte e dukshme edhe me mendimet dhe rekomandimet e Mbrojtësit të qytetarëve në lidhje me ankesat e prindërve të fëmijëve të moshës shkollore, e të cilët me gabimin e institucioneve publike nuk kanë vijuar programin e obligueshëm përgatitor parashkollor.

Tradicionalisht, Ministria e punëve të brendshme është organ ndaj të cilit paraqiten më së shumti ankesa nga ana e qytetarëve, por e cila njëkohësisht e ka bashkëpunimin më efektiv me Mbrojtësin e qytetarëve në hetimin e meritave të tyre dhe eliminimin e dobësive të identifikuara. Bashkëpunimi i mirë është zhvilluar edhe me Ministrinë e Mbrojtjes, si në interes të qytetarëve të cilët janë të angazhuar në vrullin e punëve të kryera nga kjo ministri, ashtu edhe, shumë më shpesh, në interes të të punësuarve në Ministri dhe të pjesëtarëve të Ushtrisë së Serbisë.

REKOMANDIMET ME QËLLIM TË PËRMIRËSIMIT TË POZITËS SË QYTETARËVE NË RAPORT ME ORGANET E ADMINISTRATËS

- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të miratojë edhe dispozitat mbi bashkëpunimin me Mbrojtësin e qytetarëve dhe me organet tjera të pavarura të kontrollit.
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të kërkojë nga Këshilli i lartë gjyqësor që të fillojë të zbatojë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me Mbrojtësin e qytetarëve në procedurat brenda kompetencave të tij.
- Është e nevojshme që komisioni kompetent i Kuvendit Popullor të shqyrtojë raportin special të Mbrojtësit të qytetarëve lidhur me vizitën parandaluese kontrolluese Agjencionit të sigurisë dhe informimit.
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të shqyrtojë dhe të mbështesë zbatimin e Kodit të qeverisjes së mirë i cili i është parashtruar nga Mbrojtësi i qytetarëve.
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të shqyrtojë raportin mbi rastin e "foshnjave të humbur" që ia ka parashtruar Mbrojtësi i qytetarëve.
- Është e nevojshme që Qeveria të vendosë për Iniciativën e Mbrojtësit të qytetarëve për ndryshimin e nenit 50 të Ligjit për kulturë.
- Është e nevojshme që Qeveria të shqyrtojë iniciativën e Mbrojtësit të qytetarëve për përpunimin normativ të mënyrës së realizimit të dispozitave kushtetuese e cila parasheh që gjatë punësimit në organet shtetërore, shërbime publike, në organe të krahinave autonome dhe autoritete lokale, të ketë parasysh përbërjen etnike të popullsisë dhe përfaqësimin e duhur të pjesëtarëve të pakicave kombëtare.
- Është e nevojshme që Qeveria në punën e ardhshme të mos propozojë ndryshime në buxhetin e Mbrojtësit të qytetarëve pa u konsultuar me të dhe pa pëlqimin e tij, në përputhje me ligjin.
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të theksojë rëndësinë e mbrojtjes së plotë dhe efektive të aktivistëve dhe organizatave të shoqërisë civile të cilët angazhohen për avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të bëjnë thirrje për krijimin e mjedisit stimulues për punën e tyre.
- Është e nevojshme që organet kompetente të forcojnë efektivitetin e hetimit dhe të ndjekjes së veprave penale të kryer me shprehjen dhe bartjen e qëndrimeve që sanksionohen penalisht në Internet.
- Është e nevojshme që Qeveria e Republikës së Serbisë në mënyrë më efektive të informojë organet kompetente dhe opinionin publik në lidhje me vendimet e saj (konkluzionet, etj.) të cilat ndikojnë në mënyrën e realizimit të të drejtave të qytetarëve.
- Është e nevojshme që Qeveria t'i qaset sa më shpejtë përgatitjes së propozimit të projektligjit për restituim (kthim të pronës).
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor të ratifikojë Protokollin Opsional të Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
- Është e nevojshme që organet kompetente të inspektimit në Ministrinë e financave dhe organe të tjera të intensifikojnë kontrollin e pagesës së kontributeve të obligueshme për të punësuarit dhe të marrin masa kundër punëdhënësve që shkelin ligjin.
- Është e nevojshme që Qeveria të mbajë dialog social në kohën e duhur dhe kuptimplotë me përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve.

- Është e nevojshme që ministritë përkatëse të përgatisin ndryshimin e ligjit me të cilat do të përcaktohet obligimi i shpalljes së konkursit publik për lidhje të marrëdhënies së punës në të gjitha organet dhe organizatat në sektorin publik.
- Është e nevojshme që Kuvendi Popullor, nëpërmjet dëgjimit publik ose mënyrave të tjera të përshtatshme, të vlerësojë nëse ka nevojë të mbetet mundësia që të punësuarit në organet e administratës publike (organet qeveritare, krahinore, të qeverisjes lokale, shërbimit publik, organizatave me kompetenca publike ...), pa mekanizma special të mbrojtjes nga keqpërdorimi, mund të bëjnë punën e njëjtë (publike ose private) edhe përtej orarit të rregullt, e që kjo të mos përbëjë një lloj të konfliktit të interesit.
- Është e nevojshme që "e drejta në qeverisje të mirë" të jetë e përfshirë ndër të drejtat themelore të qytetarëve.
- Është e nevojshme që Qeveria, nëpërmjet Ministrisë përkatëse, të konsiderojë mundësinë e përcaktimit të kushteve me të cilat organizatave të shoqërisë civile mund t'iu pranohet statusi i organizatave të cilat kryejnë aktivitetet me interes të përgjithshëm, dhe si të tilla t'iu aprovohen lehtësime tatimore.
- Është e nevojshme që me ndryshimet e ligjit të mundësohet transparenca e plotë e pronësisë ndaj mediave.
- Iu rekomandohet shoqatave kombëtare të gazetarëve të forcojnë rolin vetë-rregullues.
- Në fushën e arsimit, fillor dhe të mesëm, të aplikohet si duhet parimi i arsimit gjithëpërfshirës në mënyrë që të lehtësojë zhvillimin e secilit fëmijë dhe talentit të tij, potencialin mental dhe fizik deri në mundësinë e fundit. Për të arritur përparim në këtë fushë të implementohet si duhet Rregullorja për mbështetje arsimore, shëndetësore dhe sociale shtesë për fëmijët dhe nxënësit, dhe të krijohen kushte të favorshme për punë të komisioneve të interesuara komunale për ofrimin e mbështetjes arsimore, sociale dhe shëndetësore shtesë për fëmijët.
- Dhuna dhe racizmi ndaj fëmijëve romë të luftohet fuqishëm, kudo që shfaqet. Përgjegjësi të veçantë për të tejkaluar këtë problem e kanë institucionet e arsimit, qysh nga parashkollorë.
- Vazhdimi i përgatitjes së Ligjit për të drejtat e fëmijës (Grupi punues i Mbrojtësit të qytetarëve), të përfshihen në procesin e konsultimit mbi projektligjin organet kompetente shtetërore dhe të sigurohet ekspertiza e Këshillit të Evropës.
- Zhvillimi i protokolleve për bashkëpunim ndërmjet ministrive përkatëse - mirëqenies sociale, drejtësisë, shëndetësisë, arsimit dhe të punëve të brendshme, për bashkëpunim efikas dhe në kohën e duhur në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e mbrojtjes familjare dhe ligjore të fëmijëve, me qëllim të reagimit efikas të rrëmbimit prindëror të fëmijës, parandalimin e fëmijës që të krijojë marrëdhënie personale me prindin tjetër dhe mosrespektimin e vendimeve të gjykatës mbi kujdestarinë e fëmijës nga ana e prindërve/personave të tjerë.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre t'iu lehtësohet qasja në trajtimet dhe ndihmesat e nevojshme.
- Krijimi i një baze të centralizuar të të dhënave mbi rastet e dhunës kundër fëmijëve, sidomos seksuale.
- Në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimin seksual, është e nevojshme që të bëhen ndryshime të Ligjit penal në pjesën që ka të bëjë vjetërsimin e lëndëve të krimeve të dhunës seksuale, të përcaktohet dhe të mirëmbahet evidence e autorëve të këtij krimi, si pjesë e mbrojtjes parandaluese, vazhdimisht të edukohen fëmijët sipas sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, duke filluar nga edukimi parashkollor.

- Në përputhje me detyrimet sipas Konventës dhe anëtarësisë së Këshillit të Evropës, Serbia duhet të hartojë një fushatë afatgjate për të mbrojtur fëmijët nga kjo formë e dhunës dhe për të krijuar një ekip për të zbatuar këto strategji në nivel kombëtar.
- Organet dhe trupat e përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve të mediave duhet të reagojnë në të gjitha rastet kur mediat publikojnë informata që përbën një shkelje të të drejtave të privatësisë dhe shkeljen e nderit dhe reputacionit të fëmijës, duhet të shqiptohen masa, gjegjësisht të propozojnë ndëshkimin e mediave të paraparë me ligj.
- Miratimi i dispozitave me të cilat do të përcaktohen mekanizma kombëtarë parandalues sipas Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimit ose procedurave tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (afati ka skaduar disa vjet më parë, Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave ka përgatitur një projekt-propozim dhe ka marrë mendimin e ministrive përkatëse).
- Në Buxhetin e Republikës së Serbisë të ndahen mjete për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve për paraburgim në polici, në mënyrë që personave të paraburgosura nga policia t'i sigurohet strehim në përputhje me standardet e aplikueshme (ndërtimi i objekteve për paraburgim policor në departamentet dhe stacionet e policisë aty ku nuk ekzistojnë, si dhe renovimi i atyre objekteve ekzistuese që kanë kushte të pamjaftueshme).
- Në Buxhetin e Republikës së Serbisë të ndahen mjetet për ndërtimin dhe renovimin, dhe zhvendosjes nga zonat qendrore urbane të enteve të caktuara për ekzekutimin e sanksioneve penale, në mënyrë që personave të privuar nga liria t'iu sigurohen kushtet e jetesës në përputhje me standardet e aplikueshme.
- Miratimi i ligjit që do të rregullojë mënyrën dhe procedurën, si dhe organizimin dhe kushtet e trajtimit të të sëmurëve mendorë, apo strehimin e atyre personave në kujdesin shëndetësor spitalor, përkatësisht institucionet psikiatrike.
- Miratimi i rregulloreve që përcaktojnë lëvizjen e lirë të personave të vendosur në institucionet stacionare sociale për vendosjen e njerëzve me aftësi të kufizuara mendore ose me aftësi të kufizuara të zhvillimit, si dhe personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, përkatësisht mundësia që vullnetarisht të largohen nga këto institucione.
- Miratimi i rregulloreve me të cilat do të mundësohet zbatimi më intensiv i masave alternative në vend të masave të ndalimit dhe sanksionet alternative në vend të burgimit, zgjerimi i kushteve për lirim me kusht dhe lirim të parakohshëm, përcaktimi i kompetencave të gjyqtarëve për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe shërbimeve sprovuese (në përputhje me Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Serbisë në uljen e mbipopullimit të kapaciteteve të vendosjes në ente për ekzekutimin e sanksioneve penale në Republikën e Serbisë në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2015).
- Miratimi i dispozitave me të cilët do të sigurohet që për kundërvajtjet e kryera, në vend të dënimeve me burg të parashikuara tash, të shqiptohen sanksione alternative, si dhe dënimi me burg në rast të mospagimit të gjobave të mos zëvendësohet me burg, por me sanksionet alternative, kryesisht duke punuar në interes të publikut.
- Miratimi i rregulloreve me të cilat do të sigurohet kompletimi optimal i kuadrove dhe rrjedha e mjeteve të nevojshme materiale në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale, në mënyrë që të sigurohet strehim dhe kushte të tjera të jetesës për personat e privuar nga liria.
- Miratimi i rregulloreve me të cilat shërbimet për kujdesin shëndetësor në entet për ekzekutimin e sanksioneve penale të transferohen nga Ministria e drejtësisë në Ministrinë e shëndetësisë.
- Ndryshimi i Ligjit mbi Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare në mënyrë që të sigurohet: a) pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve që u përkasin pakicave etnike në ushtrimin e pushtetit të pakicave në kompetencë të qeverisjes lokale; b) reduktimin e ndikimit të partive politike në procesin e zgjedhjeve të këshillave nacionale të pakicave

kombëtare dhe në aktivitetet e tyre; v) forcimin e garancionit për lirinë e qytetarëve që të regjistrohen në listat zgjedhore.

- Në përputhje me ligjin për Këshillat Kombëtare për Pakicat kombëtare, të organizohet financimi i vetëqeverisjes së pakicave.
- Me ndryshimet e Ligjit për vetëqeverisje lokale, është e nevojshme të përcaktohen përgjegjësi të qarta të vetëqeverisjeve lokale në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave kombëtare.
- Amendamenti i nenit 98 të Ligjit mbi qeverisjen lokale në mënyrë që të përcaktohet pozitë gjithëpërfshirëse dhe e përshtatshme, kompetencat dhe zgjedhja e anëtarëve dhe marrëdhëniet e organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale me Këshillat për Marrëdhëniet Ndëretnike.
- Zhvillimi i sistemit te monitorimit dhe mbikëqyrjes për zbatimin e të drejtave të pakicave kombëtare duke e forcuar mbikëqyrjen e inspeksionit; përcaktimin e burimeve të sakta të të dhënave për realizimin e të drejtave.
- Me ndryshimet e Ligjit për përdorim zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit, të sigurohet, si mbrojtja e plotë e alfabetit cirilik dhe të Serbisë, ashtu edhe realizimin e plotë të së drejtës për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të pakicave kombëtare.
- Me miratimin e akteve nënligjore t'iu mundësohet të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale, praktikë të njëjtë të regjistrimit të emrave personal të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në gjuhën dhe alfabetin e tyre.
- Miratimi, sigurimi dhe zbatimi i duhur i dispozitave kundër diskriminimit në fusha jetike për realizimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht të grupeve të cenueshme si romët, pakicat të tjera etnike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe të tjerët.
- Në përputhje me Strategjinë për përmirësimin e pozitës së Romëve, dhe Planit të Veprimit, të miratohen akte nënligjore me të cilët sigurohet dhe rregullohet përmbushja e qëllimeve strategjike.
- Përcaktimi i obligimit dhe sigurimi i kushteve institucionale që pjesëtarët e pakicave etnike, gjatë arsimimit të zotërojnë gjuhën serbe deri në nivelin e integrimit social, dhe pjesëtarët e komunitetit serb në njësitë e vetëqeverisjes lokale me një përbërje të përzier të popullsisë të flasin gjuhët e pakicave kombëtare lokale.
- Të sigurojë regjistrimin efikas dhe të shpejtë, ose përtëritjen e regjistrimit të lindjeve të personave të cilët nuk e kanë atë status.
- Sigurimi i kushteve për ushtrimin pa pengesa të lirisë së fesë, e cila përfshin edhe procedurë të hapur dhe të qartë të regjistrimit të kishave dhe komuniteteve fetare në regjistrin përkatës.
- Të sigurohet mbrojtja e identitetit kulturor të pakicave etnike dhe të forcohen lidhjet e integrimit social ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike, gjuhësore dhe fetare përmes sistemeve arsimore dhe kulturore të përshtatura për nevojat e qytetarëve të Serbisë.

TË DHËNAT STATISTIKORE DHE NUMERIKE MBI AKTIVITETET E MBROJTËSIT TË QYTETARËVE

I KONTAKTI ME QYTETARË

Gjatë vitit 2010 Mbrojtësi i qytetarëve ka realizuar 11.225 kontakte me qytetarë (tabela 1), që paraqet një rritje prej 28,05% në raport me vitin 2009, kur ka realizuar 8.774 kontakte me qytetarë.

Rritja e numrit të kontakteve të cilat i ka realizuar Mbrojtësi i qytetarëve tregon se qytetarët te Mbrojtësi i qytetarëve shohin një organ i cili ka autorizime domethënëse në sistemin juridik të Republikës së Serbisë në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të tyre, por edhe të avancimit të dispozitave ligjore nga sfera e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Tabela 1. Të gjitha kontaktet e realizuara me qytetarë gjatë vitit 2010

Numri rendor	KONTAKTET E REALIZUARA TË MBROJTËSIT TË QYTETARËVE – RRITJA 2009-2010.	2009.	2010.	Rritja në %
1.	Ankesat e pranuara	1.774	2.656	50,23
2.	Iniciativat e pranuara gjyqësore	55	75	64,56
3.	Qytetarë të pranuar në bisedë	1.741	2.865	36,36
4.	Bisedat telefonike me qytetarë	5.044	5.058	0,28
5.	Parashtresat e ndryshme të qytetarëve përveç ankesave	160	571	261,39
	Gjithsej	**8.774**	**11.225**	**28,05**

Në zyrën pritëse të Mbrojtësit të qytetarëve në Beograd dhe në zyrën lokale për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje gjatë vitit 2010 janë pranuar 2865 qytetarë që është më shumë se në vitin 2009 për 36,36%. Njëkohësisht, janë realizuar 5.058 thirrje telefonike prej të cilëve 712 thirrje telefonike janë realizuar jashtë orarit të punës së Mbrojtësit të qytetarëve, përmes numrit kujdestar SOS i cili është në funksion 24 orë në ditë në mënyrë që qytetarëve në nevojë t'iu ndihmohet me këshillë apo me mbështetje.

Grafikoni tregon lloje të ndryshme të kontaktit me qytetarët, pa ankesa të shkruara dhe iniciativa ligjore, për të cilat do të bëhet fjalë në pjesët e veçanta të raportit.

Grafikoni 1. Kontakti me qytetarë (pranimi, thirrjet telefonike, parashtresat e ndryshme)



(Prijem gradjana – pranimi i qytetarëve, telefonski kontakti – kontaktet me telefon, razni... – Kërkesat e ndryshme të pranuara – përveç ankesave, ukupno – gjithsej)

Në zyrat e pranimit me qytetarët bisedojnë, në mënyrë direkte ose me telefon, shërbyes të aftësuar shtetërorë të cilët ofrojnë këshilla mbi mënyrën e paraqitjes së ankesës tek Mbrojtësi i qytetarëve. Sipas nevojës, ata i ndihmojnë qytetarëve që të hartojnë ankesën dhe/edhe u japin këshilla profesionale, gjegjësisht i referojnë te organet të cilave duhet t'iu drejtohen dhe u bëjnë me dije veprimet të cilat duhet t'i ndërmarrin me qëllim të zgjidhjes së problemit të tyre. Grafikoni 2 tregon raportin ndërmjet ankesave të pranuara me gojë dhe me shkrim të evidentuar në zyre pritëse, gjegjësisht raportin e problemeve të parashtruara nga qytetarët në kompetencë të AP dhe ato që nuk janë. Duke ndihmuar punës së të punësuarve në zyrën e pranimit ky raport më vonë ndryshon në dobi të ankesave të parashtruara me shkrim të cilat janë në kompetenca të Mbrojtësit të qytetarëve.

Grafikoni 2. Arsyet për paraqitjet me gojë në zyrat e pranimit të AP


Надлежност ЗГ
36.54%
Није надлежност ЗГ
63.46%

(nadleznost ZG – kompetenca e AP, nije nadleznost ZG – nuk është kompetenca e AP)

Qytetarët të cilët në mënyrë direkte kontaktojnë zyrat pritëse të Mbrojtësit të qytetarëve, qoftë me ardhje apo me thirrje telefonike, kryesisht janë nga Beogradi. Kjo është pasojë e pamundësisë së qasjes zyrave nga qytetarët jashtë qarkut të Beogradit, me përjashtim të zyrave lokale në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, për të cilat më vonë do të bëhet më shumë fjalë, por edhe kostos së rritur të thirrjeve telefonike për qytetarët jashtë Beogradit. Në periudhën e ardhshme, Mbrojtësi i qytetarëve do të përqendrohet në gjetjen e zgjidhjes për një qasje më të madhe të zyrave të tyre për qytetarët.

Grafikoni 3. Vendbanimi i qytetarëve të cilat iu drejtohen zyrave pritëse të AP



(ostali delovi Srbije – pjesët tjera të Serbisë, Beograd – Beograd, Opstina Presevo...-Komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, AP KiM – KA KeM, AP Vojvodina – KA e Vojvodinës, ukupno – gjithsej)

Mbrojtësit të qytetarëve me qëllim të pranimit më shumë i drejtohen meshkujt sesa femrat, por numri i femrave që i drejtohen Mbrojtësit të qytetarëve rritet në raport me vitet paraprake kur ishte diçka më i ulët se 30%.

Numri i femrave të cilat vizitojnë zyrat përgatitore të Mbrojtësit të qytetarëve në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje është ende shumë më i ulët në raport me meshkujt, gjë që deri diku është pasojë e raportit tradicional në familjet e këtyre zonave.

Grafikoni 4. dhe 5. Pranimi i qytetarëve në zyrat e Beogradit dhe të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës

(prijem gradjana – odnos polova – pranimi i qytetarëve – raporti gjinor, prijemna kancelarija u Beogradu – zyra pritëse në Beograd, muskarci – meshkujt, zene – femrat)

II VEPRIMI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE SIPAS ANKESAVE

Çdo person fizik apo juridik, vendor apo i huaj i cili konsideron se me ndonjë akt, veprim apo mosveprim të organeve të administratës i janë shkelur të drejtat, mund të parashtrojnë ankesë te Mbrojtësi i qytetarëve. Mbrojtësi i qytetarëve është i obliguar që të veprojë sipas çdo ankese, përveç nëse i mungon baza për të vepruar e definuar me ligj, me ç'rast refuzon ankesën dhe njofton parashtruesin e ankesës, duke cekur arsyet për refuzim.

Numri dhe klasifikimi i ankesave

Mbrojtësit të qytetarëve mund t'i drejtohet çdokush (shtetas i Serbisë, personat juridik, apatridët, refugjatët, të zhvendosurit, të rriturit dhe fëmijët, shoqatat e ndryshme) të cilët konsiderojnë se organet e administratës në mënyrë të parregullt dhe/ose jokorrekte zbatojnë ose nuk zbatojnë dispozitat e Republikës së Serbisë. Ankesa e cila iu referohet Mbrojtësit të qytetarëve është pa pagesë dhe parashtrohet në formë të shkruar apo me gojë në procesverbalin e Mbrojtësit të qytetarëve.

Gjatë vitit 2010, Mbrojtësi i qytetarëve ka pranuar 2.656 ankesa.

Tabela 2. jep të dhëna mbi karakteristikat e parashtruesve të ankesave dhe mënyrën e parashtrimit të tyre.

Tabela 2.

Meshkujt	1400	52,77%
Femrat	803	30,27%
Personat fizik	1925	72,56%
Personat juridik	141	5,31%
Me iniciativë të vetë AP	81	3,05%
Ankesa e parashtruar për personin tjetër	141	5,31%
Prindi në vend të fëmijës	161	6,07%
Ankesa anonime	16	0,60%
Shtetasit vendor	2295	86,51%
Shtetas të huaj	42	1,58%
Ankesa e parashtruara individualisht	2193	82,66%
Ankesat kolektive	174	6,56%
Të parashtruara me postë	1259	47,46%
Të parashtruara personalisht	513	19,34%
Ankesat e pranuara me procesverbal	14	0,53%
Të arritur me email	543	20,47%
Të parashtruar përmes ombudsmanëve lokal	48	1,81%
Parashtruar përmes ombudsmanëve të jashtëm	4	0,15%

Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas qarkut administrativ, gjegjësisht vendbanimit të parashtruesit

Parashtruesit e ankesave në masë më të madhe janë nga Beogradi, mirëpo, ka edhe parashtrues nga të gjitha qarqet e Serbisë. Kjo është e kuptueshme, sepse Beogradi ka shumë më tepër banorë sesa cili do qytet tjetër në Serbi sepse, si kryeqytet, është seli e numrit më të madh të organeve qeverisëse.

Grafikoni 6. – Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas qarkut të parashtruesit të ankesës



(ukupno – gjithsej, ostali delovi Srbije – pjesët tjera të Serbisë, Beograd – Beogradi, AP Vojvodina - KA e Vojvodinës, Nisavski – Nishi, Branicevski – Braniqevcit, Raski – Rashkës, Opstine Presevo ..Komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, Strana drzava – shteti i huaj, AP KiM – KA KeM, broj i klasifikacija... – numri dhe klasifikimi i ankeave sipas qarkut administrativ të parashtruesit të ankesës/vendbanimit)

Pas marrjes së Vendimit të Mbrojtësit të qytetarëve mbi themelimin e zyrave lokale në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës ("Gazeta zyrtare e RS-së, nr 91/09), me qëllim të rritjes së mundësisë për qasje te institucioni i Mbrojtësit të qytetarëve dhe realizimit të mbrojtjes më efikase si dhe avancimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të pakicave dhe të qytetarëve, gjatë vitit 2010 janë pranuar gjithsej 78 ankesa nga kjo zonë gjë që paraqet 3% të numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuara në vitin 2010.

Grafikoni 7. Numri i ankesave të pranuara nga trevat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuara (ostale..-komuna tjera në Serbi, Presevo...-Presheva, Bujanoci dhe Medvegja)


Остале општине у Србији
2578
97%
Прешево, Бујановац и Медвеђа
78
3%
УКУПНО: 2656

Mbrojtësi i qytetarëve, zëvendësit e Mbrojtësit të qytetarëve si dhe të punësuarit në shërbimin profesional, sipas planit të përcaktuar më herët një herë në muaj shkojnë në zyrat lokale me qëllim të ofrimit të ndihmës profesionale të punësuarve në këto zyre. Me këtë rast, bëhen edhe biseda me qytetarë dhe pranohen ankesat e tyre por njëkohësisht kryhen edhe bisedat me përfaqësues të organeve lokale të cilat ushtrojnë funksionet e besuara në zbatimin e dispozitave republikane.

Grafikoni 8. – Numri i ankesave nga qytetarët e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje (ukupno – gjithsej)



Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas të drejtave të shkelura, të pranuara nga qytetarët e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje

Përmbajtja e ankesave tregon se qytetarët nga këto tre komuna, si dhe qytetarët nga pjesët tjera të Serbisë, më së shpeshti parashtrojnë ankesa të cilat iu referohen shkeljes së parimit të "qeverisjes së mirë". Në raport me vitin 2009 kur nga këto tre komuna janë pranuar vetëm tre ankesa të cilat iu referoheshin të drejtave të pakicave kombëtare, në vitin 2010 numri i këtyre ankesave është rritur në 14.

Tabela 3.

Sfera qeverisëse	Bujanoci	Presheva	Medvegja	Gjithsej sipas sferave të qeverisjes
Qeverisja e mirë	18	11	14	**43**
Të drejtat civile dhe politike	3	4		**7**
Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare	7	2	5	**14**
Të drejtat e fëmijëve	3		2	**5**
Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	2	1		**3**
E drejta në gjykim të drejtë	2	1		**3**
Barazia gjinore	1	1		**2**
E drejta e personave të privuar nga liria		1		**1**
Gjithsej sipas komunave	**36**	**21**	**21**	**78**

Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas të drejtave të shkelura

Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas të drejtave të shkelura tregojnë se më të shpeshta janë rastet e shkeljes së parimit të "qeverisjes së mirë", të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe shkeljes së të drejtave civile dhe politike.

Grafikoni 9. – Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas të drejtave të shkelura

Shënim: numri i të drejtave të shkelura është më i madh nga numri i ankesave, pasi që ankesat tregojnë për shkeljen më shumë se një të drejte

(ukupno-gjithsej, gradjanska ..- të drejtat civile dhe politike, ekonomska...-të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, dobra uprava- qeverisja e mirë, prava deteta-të drejtat e fëmijëve, prava lica lisena slobode-të drejtat e fëmijëve të privuar nga liria, prava lica sa invaliditetom – të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, prava pripadnika nacionalnih manjina – të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare)

Numri dhe klasifikimi i ankesave ndaj organeve të cilat iu referohen punës së tyre

Numri më i madh i ankesave iu referohet punës së përfaqësuesve të organeve ekzekutive, posaçërisht Ministrisë së Republikës së Serbisë; në punën e organeve në sferën e sigurimit penzional dhe invalidor, punësimit dhe mbrojtjes shëndetësore; por gjithashtu edhe në punën e ndërmarrjeve publike, organeve tatimore, qendrës për punë sociale, shkollave, instituteve të fëmijëve, gjykatave dhe burgjeve.

Grafikoni 10. – Ankesat sipas organeve të cilat iu referohen punës së tyre



(ukupno – gjithsej, prituzbe prema...-ankesat ndaj organeve të cilat iu referohen punës së tyre, ministarstva – ministritë, ustanove i druge jave sluzhbe – institutet edhe shërbimet tjera publike, rep. Agencije...-agjencionet republikane, entet, fondet, drejtoratet dhe drejtoritë, organi lokalne samouprave – organet e vetë-qeverisjes lokale, privredna drustva...-shoqëritë afariste, punëdhënës privat, etj., samostalni rep. Organi – organet e pavarura republikane dhe organet e pavarura, pravosudni organi – organet e gjyqësorit, javna preduzeca – ndërmarrjet publike)

Numri dhe klasifikimi i ankesave sipas ministrive të cilat iu referohen punës së tyre

Numri më i madh i ankesave iu referohet punës së Ministrisë së punëve të brendshme (trafikoni 11), duke marrë parasysh se kjo ministri ka kompetenca të vendos mbi të drejtat dhe liritë jetike të qytetarëve. Gjithashtu, kjo ministri gjatë vitit 2010, si edhe gjatë vitit 2009, ka zbatuar një punë të madhe të zëvendësimit të dokumenteve personale të qytetarëve. Gjatë kësaj pune, ka pasur lëshime domethënëse në punë, ashtu siç kishte cekur edhe Mbrojtësi i qytetarëve, por duhet pasur parasysh se pjesa më e madhe e këtyre lëshimeve ka rrjedhur nga vështirësitë objektive. Mbrojtësi i qytetarëve i ka drejtuar Ministrisë së punëve të brendshme disa rekomandime, e cila ka reaguar me kohë gati në të gjitha rekomandimet.

Grafikoni 11. – Ankesat sipas ministrive të cilat iu referohen punës së tyre (ukupno – gjithsej, min. Unutr. – ministria e punëve të brendshme, min. Prosvete-ministria e arsimit, min. Pravde – ministria e drejtësisë, min. Finans. – ministria e financave, min. Odbrane – ministria e mbrojtjes, min. Zdravlja – ministria e shëndetësisë, ostala min. – ministritë e tjera, prituzbe prema...-ankesat sipas ministrive të cilat iu referohen punës së tyre)


УКУПНО 637
300
250
200
150
100
50
0
265
77
69
44
43
39
30
70
Мин. унутрашњих послова
Мин. просвете
Мин. рада и социјалне политике
Мин. правде
Мин. финансија
Мин. одбране
Мин. здравља
Остала министарства
ПРИТУЖБЕ ПРЕМА МИНИСТАРСТВИМ НА ЧИЈИ СЕ РАД ОДНОСЕ
265
77
69
44
43
39
30
70

Rezultati i veprimeve të Mbrojtësit të qytetarëve sipas ankesave

Mbrojtësi i qytetarëve kryen procedura sipas ankesës, përveç për ankesat të cilat nuk është kompetent, të cilat nuk parashtrohen me kohë, para kohe, anonime, të parregullta apo të parashtruara nga personi i paautorizuar.

Mbrojtësi i qytetarëve njofton parashtruesin e ankesës mbi inicimin dhe përfundimin e procedurës, si dhe organin administrativ ndaj të cilit është parashtruar ankesa. Organi administrativ ka obligimin ligjor që t'iu përgjigjet të gjitha kërkesave të Mbrojtësit të qytetarëve, si dhe t'i parashtrojë informatat e kërkuara dhe shkresat e kërkuara, në afat prej 15 deri në 60 ditë.

Kur është fjala për ankesat nga viti 2010, Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka vepruar në 2.545 raste të cilat janë iniciuar me ankesë apo me iniciativë të vet në vitin 2010, me ç'rast ka vepruar në 1,559 raste të lidhura me ankesat e periudhës së mëhershme. Në 44 ankesa të cilat kanë arritur gjatë muajit dhjetor 2010, nuk ka pasur ndonjë aktivitet deri në 31.12.2010.

Gjatë vitit 2010, prej 2,545 rasteve në të cilat ka punuar, ka përfunduar punën në 1.929. Në numrin më të madh të rasteve (952) ankesat janë hedhur poshtë për shkak të mosekzistimit të bazës për të kryer procesin, ndërsa në rastet tjera (977) procedura ka përfunduar në mënyrën gjegjëse (tabela 4). Procedurat e tjera të filluara (680) janë në vazhdimësi e sipër.

Grafikoni 12. Puna në ankesat e pranuara gjatë vitit 2010



(nije bilo aktivnosti na prituzbama – nuk ka pasur aktivitete ndaj ankesave, okoncan rad... – puna në ankesë ka përfunduar, prituzbe kod kojih...-ankesa për të cilat procedura është në vazhdim e sipër)

Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka vepruar ndaj 934 ankesave të cilat janë parashtruar në periudha të mëhershme dhe në këtë mënyrë ka përdhunuar procedurën në 45 sosh, ka hedhur poshtë 264 ankesa ndërsa në 205 të tjera procedurat janë në zhvillim e sipër.

Tabela 4. – Procedurat e përfunduara nga Mbrojtësi i qytetarëve sipas ankesave në vitin 2010

Numri rendor	PROCEDURAT E PËRFUNDUARA NGA MBROJTËSI I QYTETARËVE GJATË VITIT 2010	Numri
1	Ankesat e refuzuara si të pabaza	574
2	Rekomandimet – individuale dhe kolektive	229
3	Procedura e ndërprerë – organi qeverisës ka eliminuar mangësinë në punë	134
4	Parashtruesit e ankesës kanë tërhequr ankesën	39
5	Mendime – sipas nenit 24. par. 2 të Ligjit mbi AP	1
	Gjithsej:	**977**

Rekomandimet

Në vitin 2010 janë sjellë gjithsej 140 rekomandime të cilat iu referohen 272 ankesave për shkak të faktit se 21 rekomandime kolektive iu referohen më shumë se një ankese të vetme. Deri më 31.12.2010, organet të cilave iu janë drejtuar rekomandimet kanë ndërmarrë masa në rastin e 69 rekomandimeve, nuk kanë ndërmarrë masa në 35 rekomandime ndërsa për 36 rekomandime ende nuk ka skaduar afati i parashikuar përbrenda të cilit organet janë të obliguara të njoftojnë Mbrojtësin e qytetarëve mbi masat sipas rekomandimeve.

Grafikoni 13. – Organet të cilave u janë drejtuar rekomandimet

(ukupno – gjithsej, ministarstva – ministritë, lokalna samouprava – pushteti lokal, republicke agencije – agjencionet republikane, ustanove u oblasti obr. – institutet në sferën e arsimit, ustanove u oblasti soc. Zast. – institutet në sferën e mbrojtjes sociale, zatvori – burgjet, organizacije obav...-organizatat e sigurimit të obligueshëm social, urave u sastavu...-drejtoratet në përbërje të ministrive, ostalo – të tjera)

Grafikoni 14. Përqindja e zbatimit të rekomandimeve

(izvrs. Prep. – Zbatimi i rekomandimeve, nije postupljeno-nuk është vepruar, u roku za post. – përbrenda afatit për të vepruar, postupljeno – është vepruar)

Tabela 5. – Organet të cilat nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve dhe numri i rekomandimeve

Ministritë	18	51,43%
Institucionet në sferën e mbrojtjes sociale	7	20,00%
Organet e vetë-qeverisjes lokale	5	14,29%
Agjencionet republikane	2	5,71%
Institucionet në sferën e arsimit	1	2,86%
Organizatat e sigurimit të obligueshëm social	1	2,86%
Organet e pavarura shtetërore dhe organet e pavarura	1	2,86%

Grafikoni 15. Rekomandimet sipas lëmive të të drejtave 2010

(preporuke po oblast. – Rekomandimet sipas sferave 2010, opsta ljudska prava – të drejtat e përgjithshme të njeriut, prava lica lisenih slobode – të drejtat e personave të privuar nga liria, prava soba sa inv. – të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pravo na dobru upr. – e drejta në qeverisje të mirë, ukupno – gjithsej, broj p. – nr. i ankesave, izvrsenje – zbatimi, neizvr. – pazbatuar, u roku za izv. – brenda afatit për zbatim)

Ankesat e refuzuara

Gjatë vitit 2010 nga 2.656 ankesa të pranuara në këtë vit, janë refuzuar 952. Nëse Mbrojtësi i qytetarëve nuk ka pasur bazë për të udhëhequr procedurën sipas ankesave për të cilat nuk është kompetent, të cilat janë jashtë afatit, para afatit, anonime, të parregullta apo të parashtruara nga ana e personit të paautorizuar, atëherë këso ankesash është dashur t'i refuzojë (trafikoni 13). Pjesa përbërëse e shkresës së Mbrojtësit të qytetarëve me të cilën njofton qytetarët se nuk ka pasur bazë ligjore për të udhëhequr procedurën sipas ankesave për shkak të arsyeve të lartpërmendura është dhënë edhe ndihmë këshilluese – juridike. Në fakt, parashtruesit e ankesave gjithnjë udhëzohen tek procedurat gjegjëse juridike dhe/ose organet kompetente.

Mungesa e kompetencës

Mbrojtësi i qytetarëve ka refuzuar një pjesën më të madhe të ankesave për shkak të mungesës së kompetencave (463), prej të cilave numri më i madh kishte të bënte me punën e gjykatave (prej të cilave, më së shumti në punën e gjykatave themelore). Nëntë ankesa janë ceduar në kompetencë të ombudsmanëve lokalë. Qytetarët kanë parashtruar edhe tridhjetë e pesë ankesa ndaj organeve më të larta për të cilat Mbrojtësi i qytetarëve nuk është kompetent. Njëzet e dy kishin të bënin me punën e Qeverisë, të Gjykatës kushtetuese pesë, të Kryetarit të Republikës katër, të Avokatit publik republikan tre dhe një për punën e Kuvendit popullor.

Mbrojtësi i qytetarëve në paraqitjet e tij publike disa herë ka vënë në pah kompetencat ligjore të cilat i disponon, posaçërisht për organet të cilat nuk është i autorizuar t'i kontrollojë. Përkundër kësaj, Mbrojtësi i qytetarëve edhe më tej pranon një numër të madh

të ankesave të cilat iu referohen në punën dhe veprimet e pikërisht këtyre organeve, posaçërisht gjykatave. Kjo dëshmon një mosinformim ende të pamjaftueshëm të qytetarëve mbi autorizimet e Mbrojtësit të qytetarëve, por edhe në faktin se për çështjen e punës së gjykatave ekzistojnë probleme evidente të cilat qytetarët i spikasin në ankesat e tyre. Ata më së shpeshti protestojnë për shkak të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, humbjes së lëndës në gjykata, transparencës së pamjaftueshme në punën e vet, vonesat në hartimin e aktgjykimeve dhe akteve të tjera gjyqësore, mos organizimit të administratës gjyqësore, vështirësive dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatës dhe mosinformimit mbi fatin e padive penale te prokuroritë.

Ankesa e parakohshme

Mbi këtë bazë janë refuzuar 314 ankesa. Në fakt, para parashtrimit të ankesës, parashtruesi i ankesës është i obliguar që të tentojë t'i mbrojë të drejtat e veta përmes procedurës gjegjëse juridike, ndërsa Mbrojtësi i qytetarëve është i obliguar që të udhëzojë parashtruesin e ankesës që të iniciojë procedurën përkatëse juridike, nëse është parashikuar një procedurë e tillë. Mbrojtësi i qytetarëve nuk inicion procedurën nëse nuk shteren të gjitha mjetet juridike. Përjashtimisht, Mbrojtësi i qytetarëve mund të iniciojë procedurën edhe para shterjes së mjeteve juridike, nëse parashtruesit të ankesës do t'i shkaktohej dëmi i pariparueshëm apo nëse ankesa iu referohet shkeljes së parimit të qeverisjes së mirë, gjegjësisht sjelljes jokorrekte të organeve ndaj parashtruesit të ankesës, punën e vonuar apo shkeljet e tjera të parimit të rregullit të sjelljes etike të të punësuarit në organin qeverisës.

Parregullsia e ankesës

Për shkak të parregullsisë janë refuzuar 115 ankesa. Nëse ankesa nuk përmban të dhëna të duhura për të vepruar, ndërsa parashtruesi i ankesës nuk plotëson mangësitë edhe gjatë afatit shtesë për plotësimin e ankesës, i cili më së shpeshti është 15 ditë, dhe as nuk i drejtohet shërbimit të Mbrojtësit të qytetarëve për ndihmë profesionale në eliminimin e mangësive të lëndës, atëherë Mbrojtësi i qytetarëve refuzon ankesë të tillë.

Ankesa pas afatit

Për shkak të afatit të vonuar janë refuzuar 28 ankesa. Ankesa mund të parashtrohet më së voni në afat prej një viti pas shkeljes së bërë ndaj të drejtave të qytetarit, gjegjësisht nga veprimi më i fundit, gjegjësisht mosveprimit të organit në lidhje me shkeljen që i është bërë qytetarit. Gjithashtu, Mbrojtësi i qytetarëve mund të veprojë vetëm në rastet pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve (24 shtator 2005).

Anonimiteti i ankesës

Mbrojtësi i qytetarëve ka refuzuar 16 ankesa anonime. Mbrojtësi i qytetarëve nuk vepron sipas ankesave anonime, përveç me disa përjashtime, kur vendos se në ankesën anonime ka bazë për të vepruar dhe se është e mundur që të jetë bërë shkelje flagrante e të drejtave të qytetarit, atëherë inicion procedurën me nismë të vetë. Bazën për vlerësim paraqet vlerësimi i Mbrojtësit të qytetarëve, i bazuar mbi njohuritë nga ankesa anonime, se me aktin, veprimin apo mosveprimin e organit të administratës ka ardhur deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut, gjë që edhe kishte ndodhur në disa raste.

Ankesat e parashtruara nga ana e personave të paautorizuar

Janë refuzuar 16 ankesa të cilat ishin parashtruar nga persona të paautorizuar. Ankesat Mbrojtësit të qytetarëve mund të parashtrohet nga çdo person fizik apo juridik, vendor apo i huaj, i cili konsideron se me aktin, veprimin apo mosveprimin e organeve i është

bërë shkelje e të drejtave. Nëse bëhet fjalë për shkeljen e të drejtave të fëmijës, atëherë ankesën mund ta parashtroj prindi i fëmijës, gjegjësisht përfaqësuesi ligjor. Fëmijët inkurajohen t'i drejtohen Mbrojtësit të qytetarëve edhe personalisht kur për këtë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, por gjithashtu në këso situata Mbrojtësi i qytetarëve mund të iniciojë procedurën me iniciativë të vet në bazë të njohurive mbi llojin e shkeljes së të drejtave të cilët fëmije i vë në pah në paraqitjen e vet. Nëse bëhet fjalë për shkeljen e të drejtave të personit juridik, ankesën mund ta parashtrojë edhe personi i cili është i autorizuar për të përfaqësuar personin e tillë juridik.

Grafikoni 16. – Arsyet e refuzimit të kërkesës



(ukupno-gjithsej, nadleznost – kompetencat, preuranjena – parakohe, neuredan prituzba – ankesa jo e rregullt, neblagovremena – jashtë afatit, anonimna – anonime, neovlasceno lice – personi i paautorizuar)

Veprimi sipas ankesës në sfera specialistike

1. Sfera e qeverisjes së mirë

Nga 1.300 ankesa sa janë pranuar në vitin 2010 nga sfera e qeverisjes së mirë, ka përfunduar puna në 823 ankesa. Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në 514 raste dhe ka përfunduar procedurën në 494 ankesa të parashtruara. Njëkohësisht, 329 ankesa janë refuzuar për shkaqe ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka iniciuar 90 procedura të cilat iu referohen ankesave të parashtruara në vitin 2009, për 254 ankesa nga viti 2009 është përfunduar procedura ndërsa 104 ankesa janë refuzuar për arsye ligjore.

Grafikoni 17. – Procedurat e përfunduara në sferën e qeverisjes së mirë

(ukupno-gjithsej, donete zbirne...-rekomandime individuale apo kolektive të lëshuara, odbijeno kao neosnovano – refuzuar si e pabazë, organi otklonili...-organe kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë zhvillimit të procedurës së AP, prituzioci...-parashtruesit e ankesës kanë hequr dorë nga ankesa, saopstenje ZG – komunikata e AP, zavrseno postupanje – procedura e përfunduar)

Grafikoni 18. – Refuzimi i ankesave në sferën e qeverisjes së mirë



(ukupno-gjithsej, neiskoriscena pravna...-mjetet juridike të pashfrytëzuara, nenadleznost...-nuk janë në kompetencë të AP, neuredna...-ankesa jo e rregullt, neblagovremena...-ankesa jashtë afatit kohor, anonimna, anonime, podneta od neovl...-parashtruar nga persona të paautorizuar, razlozi za...-arsyet për refuzim të ankesës)

2. Sfera e të drejtave të personave të privuar nga liria

Nga 189 ankesa të pranuara gjatë vitit 2010 nga sfera e të drejtave të personave të privuar nga liria, ka përfunduar puna në 142 ankesa. Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në 31 raste. Ka përfunduar procedurën në 46 ankesa të parashtruara. Njëkohësisht, 96 ankesa janë refuzuar për shkaqe ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka iniciuar 3 procedura të cilat iu referohen ankesave të parashtruara në vitin 2009, për 23 ankesa të vitit ka përfunduar procedurën ndërsa 12 i ka refuzuar për shkaqe ligjore.

Grafikoni 19. – Procedurat e përfunduara në sferën e të drejtave të personave të privuar nga liria

(ukupno-gjithsej, odbijeno...-refuzuar si e pabazuar, donete zbirne...-rekomandime individuale apo kolektive të lëshuara, , prituzioci...-parashtruesit e ankesës kanë hequr dorë nga ankesa, organi otklonili...-organe kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë zhvillimit të procedurës së AP saopstenje ZG – komunikata e AP, zavrseno postupanje – procedura e përfunduar)

Grafikoni 20. – Refuzimi i ankesave në sferën e të drejtave të privuar nga liria



(ukupno-gjithsej, nenadleznost...-nuk janë në kompetencë të AP, neiskoriscena pravna...-mjetet juridike të pashfrytëzuara, neuredna...-ankesa jo e rregullt, anonimna, anonime, neblagovremena...-ankesa jashtë afatit kohor, podneta od neovl...-parashtruar nga persona të paautorizuar, razlozi za...-arsyet për refuzim të ankesës)

3. *Sfera e barazisë gjinore*

Nga 58 ankesa të pranuara gjatë vitit 2010 nga sfera e barazisë gjinore, puna në 33 ankesa ka përfunduar. Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në 35 raste, ka përfunduar procedurën në 17 sosh. Njëkohësisht, 16 ankesa janë hedhur poshtë për shkaqe ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka iniciuar 1 procedurë e cila ka të bëjë me ankesën e parashtruar nga viti 2009 ndërsa për 4 ankesa nga viti 2009 ka përfunduar procedurat për vitin 2010.

Grafikoni 21. – Ka përfunduar procedura në sferën e barazisë gjinore

(odbijeno kao neosnovano – refuzuar si e pabazë, organi otklonili...-organet kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë procedurës së AP, saopstenje ZG – komunikata e AP, zavrseno postupanje – procedurat e përfunduara, ukupno – gjithsej)

Grafikoni 22. – Refuzimi i ankesës në sferën e barazisë gjinore



(nenadleznost ZG – jashtë kompetencave të AP, neiskoriscena...-mjetet juridike nuk janë shterur, neuredna ...-ankea jo e rregullt, podneta od...-parashtruar nga personi i paautorizuar, ukupno-gjithsej, razlozi...-arsyet për refuzimin e ankesës)

4. Sfera e të drejtave të fëmijëve

Nga 227 ankesat e pranuara gjatë vitit 2010 nga sfera e të drejtave të fëmijëve, ka përfunduar puna në 99 ankesa. Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në 88 raste, ka përfunduar procedurën në 73 ankesa të parashtruara. Njëkohësisht, 26 ankesa janë refuzuar për shkaqe ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka iniciuar 11 procedura të cilat iu referohen ankesave të parashtruara në vitin 2009, ndërsa për 59 ankesa nga viti 2009 ka përfunduar procedurën ndërsa 1 është refuzuar për shkaqe ligjore. Gjithashtu, gjatë vitit 2010 ka përfunduar punën në 12 lëndë nga viti 2008.

Grafikoni 23. – Procedurat e përfunduara nga sfera e të drejtave të fëmijëve

(zavrseno postupanje – procedurat e përfunduara, odbijeno kao neosnovano – refuzuar si e pabazë, donete zbirne...- janë sjellur rekomandime kolektive apo individuale, organi otklonili – organet kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë procedurës së AP, prituzioci...-parashtruesit a ankesës kanë hequr dorë nga ankesa, saopstenje...-komunikimi i AP, ukupno-gjithsej)

Grafikoni 24. – Refuzimi i ankesave në sferën e të drejtave të fëmijëve

(nenadleznost ZG – jashtë kompetencave të AP, neiskoriscena...-mjetet juridike nuk janë shterur, neuredna ...-ankesa jo e rregullt, podneta od...-parashtruar nga personi i paautorizuar, ukupno-gjithsej, razlozi...-arsyet për refuzimin e ankesës)

5. Sfera e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare

Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka pranuar 91 ankesa dhe ka vepruar në 5 raste me iniciativë të vet. Mbrojtësi i qytetarëve ka përfunduar procedurat për 37 ankesa, ndërsa 40 janë refuzuar për arsye ligjore. Ka përfunduar punën në 22 ankesa nga viti 2009 ashtu që ka përfunduar procedurën në 13 raste ndërsa 9 janë hedhur poshtë për arsye ligjore.

Grafikoni 25. Procedura e përfunduar në sferën e të drejtave të pakicave kombëtare

(zavrseno postupanje – procedurat e përfunduara, odbijeno kao neosnovano – refuzuar si e pabazë, organi otklonili – organet kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë procedurës së AP, donete zbirne...- janë sjellur rekomandime kolektive apo individuale, saopstenje...- komunikimi i AP, ukupno-gjithsej)

Grafikoni 26. – Refuzimi i ankesave në sferën e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare



(nenadleznost ZG – jashtë kompetencave të AP, neiskoriscena...-mjetet juridike nuk janë shterur, neuredna ...-ankesa jo e rregullt, , neblagovremena...-jashtë orarit kohor, anonimna – anonime, podneta od...-parashtruar nga personi i paautorizuar, razlozi...-arsyet për refuzimin e ankesës)

6. Sfera e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve

Nga 94 ankesa të pranuara në vitin 2010 nga lëmia e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ka përfunduar puna në 54 ankesa. Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në 24 raste, ka përfunduar punën në 18 ankesa, 36 ankesa janë refuzuar për arsye ligjore. Mbrojtësi i qytetarëve gjatë vitit 2010 ka iniciuar 7 procedura të cilat iu referohen ankesave të parashtruar në vitin 2009, në 17 ankesa nga 2009 ka përfunduar procedurën ndërsa 6 ankesa i ka hedhur poshtë për shkaqe ligjore.

Grafikoni 27. – Procedurat e përfunduara në sferën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara



(zavrseno postupanje – procedurat e përfunduara, odbijeno kao neosnovano – refuzuar si e pabazë, organi otklonili – organet kanë eliminuar mangësitë në punë gjatë procedurës së AP, prituzioci...-parashtruesit a ankesës kanë hequr dorë nga ankesa, donete zbirne...- janë sjellur rekomandime kolektive apo individuale, ukupno-gjithsej)

Grafikoni 28. – Refuzimi i ankesës në sferën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

(nenadleznost ZG – jashtë kompetencave të AP, neiskoriscena...-mjetet juridike nuk janë shterur, neuredna ...-ankesa jo e rregullt, neblagovremena...-jashtë afatit kohor, anonimna-anonime, ukupno-gjithsej, razlozi...-arsyet për refuzimin e ankesës)

III INICIATIVAT LIGJORE DHE TË TJERA

Mbrojtësi i qytetarëve në bazë të nenit 18, par. 1 të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve ia ka parashtruar Kuvendit popullor dy amandmane në propozimin e Ligjit mbi komunikimin elektronik.

Në kuadër të veprimtarisë ligjvënëse, të orientuar kah avancimi i dispozitave ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Mbrojtësi i qytetarëve i ka parashtruar organeve dhe trupave kompetente shtatë nisma për ndryshime dhe plotësime të ligjit, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, në përputhje me nenin 18, par. 2 të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve.

Gjatë vitit 2010, Mbrojtësi i qytetarëve i ka parashtruar propozim Gjykatës Kushtetuese për inicimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të cilat iu referohen 4 dispozitave ligjore dhe atë dy në ligjin mbi komunikimin elektronik dhe dy në ligin mbi agjencionin ushtarak të sigurisë dhe agjencionit informativ ushtarak.

Grafikoni 29. – Lloje e iniciativave ligjore dhe iniciativave të tjera



	Прихваћено	Није прихваћено	У процедури	Укупно
Предлагање закона или измена закона Народној скупштини	1	1	0	2
Поднешењеиницијативе за измену или допуну закона и других прописа надлежним органима или телима	0	3	4	7
Покретање поступка пред Уставним судом за оцену уставности и законитости	0	0	4	4
Укупно иницијатива	1	4	8	13

(predlaganje zakona...-propozimi i ligjit apo i ndryshimit të ligjit Kuvendit popullor, podnesenje...-parashtrimi i iniciativave për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit dhe dispozitave të tjera organeve apo trupave kompetente, pokretanje postuaka...-inicimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ukupni inicijativa-gjithsej iniciativa, prihvaceno-pranuar, nije prihvaceno-nuk është pranuar, u proceduri-në procedurë, ukupno-gjithsej)

Grafikoni 30. – Rezultati i iniciative ligjore dhe të tjera



IV AKTIVITETE TË TJERA TË MBROJTËSIT TË QYTETARËVE

Mbrojtësi i qytetarëve në media

Grafikoni 31.

(ZG u medijima... - Mbrojtësi i qytetarëve në media 2010, stampa-shtypi, televizija-televizioni)

Gjatë vitit 2010 janë botuar 924 artikuj në 29 gazeta, dhe 280 reportazhe televizive të zhanreve të ndryshme në dhjetë televizione me mbulueshmëri kombëtare.

Mediat kanë publikuar gjithsej 53 komente mbi Mbrojtësin e qytetarëve dhe 10 intervista me Mbrojtësin e qytetarëve.

RTS, B92 dhe Pink janë televizione të cilat kanë shfaqur më së shumti interesim për punën e këtij institucioni. Mbrojtësi i qytetarëve dhe zëvendësit e tij kanë qenë mysafirë 12 herë në këto emisione dhe kanë dhënë deklarata 50 herë nga 68 të emituar.

Grafikoni 32.



(broj objava...-numri i botimeve në gazetat ditore)

Grafikoni 33



(prikaz...-pasqyrë e numrit të reportazheve televizive, B92, Pink, RTV 1, Prva, RTS 1, RTS 2, Avala, Koshara)